



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional  
në  
“Administrim Biznesi”  
i  
Institucionit të Arsimit të Lartë  
Universiteti Privat “Albanian University”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Asoc Jonida TETA


2. Dr. Alba Skëndaj

Shkurt 2023



**Për Programin e studimit Master Profesional në "Administrim Biznesi"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Albanian University
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Ekonomike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në "Administrim Biznesi"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i MASH Nr.176, datë 26.04.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	MASR Nr. 6313/2 prot, date 18.07.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.409, dt. 28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA nr.52, datë 05.07.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	38 PAE/45 PAK
18	Numri i studentëve:	14 studentë
19	Komente / të tjera:	-






## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Albanian University (AU) është një institucion privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë, i cili është licencuar në prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. Programi i studimit Master Profesional në 'Administrim Biznesi' implementohet nga departamenti i Shkencave Ekonomike, pjesë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është krijuar në vitin 2015 nga bashkimi i Fakultetit të Ekonomisë me Fakultetin e Arkitekturës dhe Inxhinierive me vendim të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë Nr.117, datë 18.12.2015 dhe Urdhër të Ministrit Nr.52, datë 05.02.2016. Fakulteti përbëhet nga tre departamente: 1. Departamenti i Shkencave Ekonomike, 2. Departamenti i Inxhinierive dhe 3. Departamenti i Art-Dizajn.

Departamenti i Shkencave Ekonomike është njësi bazë akademike që ofron dy programe studimi të ciklit të parë (Bachelor në 'Financë-Bankë' dhe në 'Menaxhim Biznesi'), katër programe studimi të ciklit të dytë (Master Profesional në a.'Menaxhim Bankar dhe Financiar', b.'Administrim Biznesi', Master i Shkencave në 'Administrim Biznesi' dhe b.'Menaxhim Bankar') si dhe është aplikuar për riorganizimin e një programi studimi të ciklit të tretë (Doktoratë).

Programi Master Profesional në 'Administrim Biznesi' është vlerësuar me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr.300, datë 13.01.2012 dhe licencuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.176, datë 26.04.2012; është akredituar për herë të parë me kusht me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr.180, datë 07.07.2016 dhe me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.440, datë 25.08.2016. Pas plotësimit të kushteve nga AU, programi kaloi sërisht procesin e vlerësimit të jashtëm nga ekspertët për shkallën e plotësimit të kushteve, proces i cili u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit nr.52, datë 10.07.2017 me disa rekomandime për të cilat institucioni kishte detyrim të raportonte brenda vitit akademik 2017-2018. Pas plotësimit të rekomandimeve AU kërkoi rishikimin e vendimit nr.52, dhe Bordi i Akreditimit konsideroi kërkesën e institucionit, duke nxjerrë vendimin nr.52/1 datë 15.12.2017. Ky vendim u shfuqizua me vendimin e Bordit të Akreditimit nr.52/2, datë 02.02.2018, i cili është dhe vendimi në fuqi për programin. AU mori masat dhe riorganizoi programin në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe rekomandimet e BA. Ky proces u miratua nga MAS me shkresën 6313/2 prot. datë 18.07.2018 dhe në vitin akademik 2018-2019 u implementua programi i riorganizuar me 60 kredite ECTS i akredituar me Vendim Nr.52 datë 05.07.2019, vlefshmëria 05.07.2019-30.09.2022 [Evidencë H.1].



3  




## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, date 11.09.2018 për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Menaxhim Bankar dhe Financiar”.

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë, në VKM nr. 109 për orgnaizmin e ASCAL, dhe në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ASCAL ka përzgjedhur me Urdhër nr.58 dt. 20.05.2022, dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga instucioni për akreditimin e programit Master Profesional në “Administrim Biznesi”. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc Jonida Teta dhe Dr. Alba Skendaj. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatorja teknike e ASCAL, Msc. Arjana Alija.

Pas komunikimit nga ASCAL, ekspertëve të jashtëm ju vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Ekspertët studiuuan dhe vlerësuan dosjen e programit, raportin e vetevlerësimit dhe gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, ngarkuar në sistem. Ekspertët mbas njohjes dhe vlerësimit të gjithë dokumentacionit, bënë përgatitjet e nevojshme, përpiluan pyetjet apo evidentuan paqartësitë e tyre, dhe u përcaktuan nëpërmjet ASCAL-it datat e vizitave në institucion. Vizita në institucion u krye në Qershor 2022. I gjithë stafi akademik dhe administrativ i Universitetit Privat “Albanian University” u angazhua për t’iu përgjigjur kërkesave të grupit të jashtëm të vlerësimit. Ekspertët kërkuan edhe dokumenta të tjera shtesë, i cili u bë i disponueshëm në datën 29 Qershor, 2022 nëpërmjet sistemit AMS.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve dhe specialistes së ASCAL, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për cdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Master Profesional “Administrim Biznesi. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë SËOT mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Më datë 20/01/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 11/2, Prot., datë 20/01/2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 26/01/2023 dhe me shkresë zyrtare Nr. 37/1 Prot., datë 26/01/2023, ku konfirmon dakordësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Administrim Biznesi”

### I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit MP në “Administrim Biznesi”, i ofruar nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara Ekonomike në Universitetin Privat “Albanian University”, përmban lëndë dhe kurrikula të cilat janë në përputhje me interesat kombëtare. Plani strategjik i Institucionit, ( <i>Referenca E.1.1, pika “Misioni”, fq. 3</i> ) përcakton se programet e ofruara nga Institucioni “janë projektuar për përgatitjen e studentëve që të bëhen qytetarë të mirë, udhëheqës të përgatitur në të ardhmen e të orientuar drejt zgjidhjeve të problematikave në çështjet lokale, rajonale dhe kombëtare”. Sikurse edhe në objektivat e programit të studimit ( <i>Referenca E.1.6, Rregullore e programit të studimit, Neni 4</i> ), programi i studimit MP në “Administrim Biznesi” është në përputhje me misionin dhe vizionin e Institucionit dhe në përputhje me interesat kombëtare.
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Ky program studimi është hartuar në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë në Shqipëri. Plani strategjik i Institucionit ( <i>Referenca E.1.1, pika “Misioni”, fq. 3</i> ) shpreh se “programet e studimit synojnë në konsolidimin e vlerave akademike kulturore e kombëtare” dhe është në përputhje me Statutin e Universitetit Privat “Albanian University”, ( <i>Referenca E.1.5, neni 2, pika 1a dhe 1g</i> ) ku përcaktohet se Universiteti Privat “Albanian University” ka si synim “të kontribuojë në rritjen e standarteve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore”
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Rregullorja e programit Master Profesional “Administrim Biznesi” ( <i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit të studimit</i> ) është mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM 41/2018 për elementët e studimit, në udhëzimet 15 dhe 31 të MAS, në Kodin e Cilësisë të Universitetit Privat “Albanian University” ( <i>E.6.4-Strategjia për</i>





	<p><i>Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i>), në manualin e ASCAL për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin si edhe në Statutin (<i>Referenca E.1.5- Statuti i Albanian University</i>) dhe Rregulloren e Universitetit Privat “Albanian University” (<i>Referenca E.1.3-Rregullore e Pergjithshme e AU</i>) dhe në Rregulloren e Departamentit të Shkencave Ekonomike (<i>Referenca E.2.3-Rregullore DSHE</i>).</p> <p>Në këtë mënyrë programi i studimit i rregulluar nga kjo rregullore ofrohet në përputhje me misionin e institucionit dhe fushën e veprimtarisë së tij të përcaktuara në statutin e tij. GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimet e Universitetit Privat “Albanian University” ku në qendër është studenti dhe kjo gjë u konstatua edhe gjatë takimeve me vetë studentët dhe stafin akademik, në ditët e vizitave në institucion.</p>			
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentat bazë dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se programi i studimit MP “Administrim Biznesi” është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. Ky program është mbështetur në “Strategjinë kombëtare për zhvillim 2016-2021”, dhe përputhet me strukturën e ekonomisë shqiptare (<i>Referenca E.1.2- Analiza e Tregut të Punës</i>). Ky program synon të formojë specialistë me profil profesional në fushën e menaxhimit bankar dhe financiar (<i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit të studimit</i>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

## Standardi I.2

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se programi i studimit Master Profesional “Administrim Biznesi” është në përputhje e në zbatim me planin strategjik të Universitetit Privat “Albanian University” (<i>Referenca E.1.1- Plani Strategjik Institucional</i>)</p> <p>Strategjia e institucionit përcakton “ofrimin e programeve studimore në përputhje me nevojat e tregut të punës”, si dhe saktëson si prioritete “garantimin e përgatitjes cilësore dhe suksesit të studentëve, ekselencë në mësimdhënie dhe kërkim</p>



	shkëncor dhe pjesëmarrje intensive në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare”. Programi i studimit MP “Administrim Biznesi” është në përputhje me planin strategjik institucional sipas prioriteteve të vendosura e të sipërpërmendura.			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Bazuar në analizën e dokumentave strategjikë të institucionit, Statuti, Plani Strategjik i Institucionit, Plani Strategjik i Departamentit, Rregullorja e Institucionit, Rregullorja e Departamentit, si edhe Rregullorja e programit të studimit dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se ky program studimi është hartuar duke u mbështetur në këto dokumenta. Pra ky program ndjek dhe zbaton misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.  <i>Referenca E.1.5- Statuti i Albanian University</i> <i>Referenca E.1.1- Plani Strategjik Institucional</i> <i>Referenca E.1.4-Plani Strategjik i Departamentit</i> <i>Referenca E.1.3-Rregullore e Pergjithshme e AU</i> <i>Referenca E.2.3-Rregullore DSHE</i> <i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit të studimit</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Ky program studimi është në zbatim të VKM nr 41 Dt.24.01.2018. Programi ofrohet nga Departamenti I Shkencave Ekonomike, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, dhe është në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Universitetit privat “Albanian University”, me misionin dhe qëllimin e Institucionit, të cilat janë të shprehura në planin strategjik të tij.  <i>Referenca E.1.1- Plani Strategjik Institucional</i> <i>Referenca E.1.4-Plani Strategjik i Departamentit</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Shqyrtimi i dokumentave bazë dhe vizita në institucion e GVJ, konfirmon se programi i studimit MP “Administrim Biznesi” është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik lokal e kombëtar. ( <i>Referenca E.1.1- Plani Strategjik Institucional</i> )			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### Standardi I.3

**Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

7



<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit rezulton se programi i studimit MP “Administrim Biznesi” ka si mision: përgatitjen e profesionistëve të fushës së menaxhimit dhe administrimit me standartet më të larta akademike bashkëkohore duke iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve të vazhdueshmë të ekonomisë.</p> <p>Ndër objektivat formues të programit përfshihen dijet, kompetencat dhe aftësitë që studentët e programit duhet të fitojnë në përfundim të tij dhe këto janë në përputhje me atë që kërkon tregu, sipas studimit të kryer (<i>Referenca E.1.6- Rregullore e programit te studimit</i>).</p> <p><i>Kërkesa e tregut nuk është përcaktuar në një studim të tregut të punës përpara hapjes së programit. Studimi I tregut të punës si edhe studentëve të diplomuar në këtë Universitet është bërë në Janar 2022. (Referenca E.1.2- Analiza e Tregut te Punes)</i></p> <p>Ky fakt krijon një hapësirë kohe pa informacion për të vlerësuar saktësisht përputhshmërinë e programit me ecurinë e tregut.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Institucioni ka kryer një studim paraprak tregu përpara hapjes së programit. Institucioni disponon të dhëna të analizuar dhe konkluzione konkrete të një studimi të tregut në përgjithësi. Në vijim në studimin e tregut të punës pas mbarimit të studimeve vërehen disa tregues të punësimit ku:</p> <p>Për vitin akademik :</p> <p>2019-2020:</p> <p>janë diplomuar 44 studentë, ndër të cilët 18 (41%) janë të punësuar në përputhje me diplomën, 11 (25%) të punësuar jo në përputhje me diplomën dhe për 15 (34%) studentë nuk ka informacion.</p> <p>2020-2021:</p> <p>janë diplomuar 21 studentë, ndër të cilët 5 (24%) janë të punësuar në përputhje me diplomën, 12 (57%) të punësuar jo në përputhje me diplomën dhe për 4 (19%) studentë nuk ka informacion.</p> <p><i>(Referenca E.1.2- Analiza e Tregut te Punes)</i></p> <p>Ajo cfarë të bie në sy nga të dhënat është një ulje e numrit të studentëve të punësuar në përputhje me diplomën.</p>



	<p><i>GVJ rekomandon, të analizohen më tej të dhënat e punësimit dhe të përkthehen në strategji për përmirësimin e programit të studimit në aspektin e objektivave dhe të mundësive të punësimit që ky program ofron.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe, lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Administrim Biznesi” ka objektiva formues të përcaktuar qartë që konsistojnë në rritjen e kapacitetit, të aftësive dhe të profesionalizmit të studentit që ose është i punësuar ose do të hyjë pas këtij programi në tregun e punës. Përmbajtja e programit mësimor me lëndë të fushës si: Ekonomiks, Strategji Biznesi, sjellje organizative, Marketingu Sipermarres (<i>Referenca Tabelat Përmbledhëse, tab.10</i>). Por në rishikim të kurrikulës së ofruar, sikurse edhe të syllabuseve, GVJ konstatoi se në planin mësimor lëndët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Metoda kërkimi të avancuara (3 kredite) e ndarë përkatësisht në 15 orë leksion, 15 orë seminar dhe 45 orë studim individual ka shumë material dhe njohuri për tu stransmetuar tek studentët.</li> <li>● Sistemet e informacionit në menaxhim (3 kredite) e ndarë përkatësisht në 15 orë leksion, 15 orë seminar dhe 45 orë studim individual jep informacion bazik për sitemet e informacionit. (<i>Referenca E.2.2-Syllabuse</i>)</li> </ul> <p><i>GVJ sygjeron, që të riorganizohet lënda Sistemet e Informacionit në Menaxhim, duke përfirë në të pse j<sup>o</sup> aplikimin dhe mësimin e përdorimit të programeve (sofëare) në fushën e menaxhimit dhe te administrimit, kjo bazuar në faktin që njohuri të ngjashme apo të njëjta me këtë lëndë në përgjithësi studentët marrin në nivelin e studimeve bachelor.</i></p> <p><i>Gjithashtu GVJ sygjeron rishikimin dhe riorganizimin e lëndës Metoda kërkimi të avancuara, duke rritur numrin e krediteve për këtë lëndë ose duke reduktuar ngarkesën e informacionit që jepet.</i></p> <p><i>E gjitha kjo, për ti ardhur më në ndihmë formimit profesional të studentëve në këtë fushë specifike dhe për të lehtësuar punësimin e tyre.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Referuar RVB, programi është hartuar duke ju referuar nevojave të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar sikurse ai është ndërkombëtarisht konkurrues në elementët përbërës së tij. Por, GVJ gjatë takimeve me dekanin dhe përgjegjës in e departamentit sikurse edhe në shqyrtimin e të gjithë dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, u</p>



	<p>evidentua se programi i studimit nuk është bazuar në kurrikula të ngjashme të ofruara nga vendet e rajonit dhe BE.</p> <p><i>GVJ bazuar në verifikimin e tij sa më sipër sugjeron se programi duhet riparë në aspektin e përmbushjes së objektivave të tij dhe, duke u krahasuar me programe të ngjashme profesionale në tregun lokal, dhe në tregje gjeografikisht afër me shtetin tonë, si në Ballkan dhe BE, për të rritur konkurrueshmërinë e studentëve.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MP “Administrim Biznesi” është hartuar bazuar në legjislacionin shqiptar i cili është në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE. Programi është në përputhje me kërkesat e Bolonjës dhe suplementi i diplomës bazohet në modelin e hartuar nga Këshilli Europian.</p> <p><i>Referenca -Extra 1-Diploma</i> <i>Referenca -Extra 2-Suplementi</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Sipas programit të studimit MP në “Administrim Biznesi” në lëndët plotësuese parashikohet “praktika profesionale” me 6 kredite në përputhje të kërkesave të ligjit. Këtë detyrim studentët e plotësojnë duke kryer praktikën në institucionet ose kompanitë ku ata aktualisht punojnë ose në institucione të tjera për të cilat Institucioni ofron mundësi. (<i>Referenca Tabela 5</i>).</p> <p><i>GVJ duke u bazuar në faktin se ky program i përket një masteri profesional rekomandon që Institucioni duhet të organizojë dhe intensivifikojë marrëdhëniet me biznesin për të ofruar praktika edhe mundësi punësimi për studentët e programit, duke përmbushur edhe objektivat e programit. Kjo nisur edhe nga numri relativisht i lartë i studentëve që janë të punësuar jo në përputhje me diplomën.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Kjo praktikë nuk aplikohet në këtë program. Programi është ofruar në gjuhën shqipe përgjatë gjithë kohës së funksionimit të tij.</p> <p><i>GVJ sugjeron se në përmbushje të objektivit të programit për të përgatitur profesionistë në fushën e menaxhimit që të jenë konkurrues në tregun ndërkombëtar, Institucioni mund të rishikojë mundësinë për të ofruar lëndë në gjuhën angleze; kjo do të ishte një mundësi përthithje e studentëve të huaj.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Programi aktual, është vënë në zbatim në vitin akademik 2018-2019 e në vazhdim. Nga viti akademik 2018-2019 e në vazhdim numri i studentëve të rregjistruar ka një ulje të numrit të studentëve të rregjistruar. Kështu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Institucioni (<i>Tabela 21</i>), sikurse edhe gjatë</p>



	<p>takimit me sekretarinë mësimore gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi se:</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019 janë 38 studentë të rregjistruar (2 prej të cilëve janë crregjistruar)</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020 janë në total 31 studentë, prej të cilëve 25 të rregjistruar për herë të parë dhe 6 të transferuar.</p> <p>Në vitin akademik 2020-2021 janë në total 29 studentë, prej të cilëve 26 të rregjistruar për herë të parë dhe 3 të transferuar.</p> <p>Nga intervistimi me përfaqësues të institucionit kjo nuk pati ndonjë shpjegim.</p> <p><i>Për këtë arsye ndoshta duhet riparë nëse arsyet e numrit të ulët të rregjistruar lidhen drejtpërdrejt me programin apo nga faktorë të jashtëm.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësies kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>GVJ konstatoi se Universiteti Privat “Albanian University” ka në dispozicion burimet njerëzore në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të tij. Staf i Fakultetit është me përvojë dhe i kualifikuar (pjesa më e madhe), në fushat specifike që mbulojnë këtë program studimi. Nga shqyrtimi i dokumentave dhe vizita në Zyrën e burimeve njerëzore, sikurse dhe në takimet me stafin u vu re që rekrutimi i stafit të ri bëhet sipas kriterëve të mirëpërcaktuara dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Referuar dokumentit <i>RVB si edhe Tabelës 1.1</i>, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike për vitin akademik <b>2020-2021</b> ka gjithsej <b>81 pedagogë</b> nga ku <b>39 pedagogë efektivë (PAE)</b>, nga të cilët: 3 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 17 kanë gradën Dr, 2 janë në process doktoreture dhe 17 Asistent Lektorë me Msc, dhe <b>42 pedagogë me kontratë (PAK)</b>.</p>



	<p>Ndërsa për Departamentin e Shkencave Ekonomike rezultojnë <b>14 staf akademik efektiv (PAE) dhe 17 staf akademik me kontratë (PAK).</b></p> <p><i>GVJ evidenton se numri i PAE në departamenti përgjegjës për këtë program studimi është më i vogël se numri i PAK.</i></p>		
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit që akreditohet është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Shkencave Ekonomike që është njësi bazë e ofrimit të tij.</p> <p>Ky program është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe aktet nënligjore në fuqi dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Ky program referuar nivelit të 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me 60 ETC dhe kohëzgjatje 1 vit akademik, në përputhje me nenin 70 pika 4 e Ligjit 80/2015.</p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet të sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>GVJ konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Shkencave Ekonomike, si njësi bazë dhe përgjegjëse për programin e studimit si edhe në përputhje të direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë MP në “Administrim Biznesi” është tërësisht në drejtimin specifik brenda profilit të institucionit.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit njësi baze përgjegjëse është Departamenti i Shkencave Ekonomike, me detyrën për të përmbushur qëllimin e programit. Departamenti mbulon me staf të kualifikuar shumicën e lëndëve/ moduleve të programit,</p>



<p>përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>ndërsa për pjesën tjetër angazhon staf nga departamentet e tjera të Fakultetit dhe staf të jashtëm. Përveç drejtuesit të Departamentit i cili kishte një rol kryesor në koordinimin e programit, Universiteti Privat “Albanian University” ka në strukturën e tij Koordinatorin e programit, roli dhe funksioni i të cilit është kryesisht administrativ. Koordinatorin e programit luan më shumë rolin e një ndërmjetësi midis studentëve dhe institucionit se sa të një personeli akademik që ndjek përmbajtjen dhe cilësinë e ekzekutimit të programit të studimit. I gjithë procesi, pra për mbikqyrjen dhe mbarevajtjen e programit të studimit u konstatua që bëhet në mënyrë të kordinuar nga të gjitha hallkat përgjegjëse dhe drejtuese e strukturës (organigrames) së Universitetit Privat “Albanian University”.</p> <p><i>Referenca E.2.9-CV Stafi Akademik 1 (1)</i>  <i>Referenca E.2.9-CV Stafi Akademik 1 (2)</i>  <i>Referenca E.2.5- Miratimi i koordinatorëve për programin e studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuara nga IAL dhe takimeve me studentët si dhe stafin, GVJ konstatoi se Universiteti Privat “Albanian University” ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi, të cilat ndikojnë në realizimin e objektivave të programit të studimit (<i>Referenca Tabela 5</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ konstatoi se në planin mësimor të këtij program studimi praktika profesionale zë një vend të rëndësishëm, ajo shoqërohet me 6 kredite (ECTS), dhe ka qëllim që studenti të zbatojë njohuritë teorike në praktikë, të ketë kontakte me tregun e punës etj. Universiteti Privat “Albanian University” ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme dhe me organizata biznesi të cilat shfrytëzohen për praktikat profesionale të studentëve (<i>Referenca Tabela 5</i>).</p> <p>Bazuar në dokumentacion por edhe në takimin me studentët gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se ndjekja dhe realizimi i praktikave të studentëve është i mirë organizuar dhe funksional.</p> <p>(<i>referuar Marrëveshjeve të bashkëpunimit</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Bashkëpunimi ndërmjet Universitetit Privat “Albanian University” dhe bizneseve për bërjen të mundur realizimin e praktikave profesionale të studentëve të këtij program studimi, bëhet nëpërmjet marrëveshjeve por edhe me anë të kërkesave të</p>



	vecanta. Gjithsesi u konstatua se institucioni/biznesi ku studentët kryejnë praktikën është e lidhur me fushën e studimit.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<i>GVJ evidentoi se Institucioni nuk ofron trajnime profesionale për studentët e diplomuar ndër vite, mbas diplomimit të tyre. Raportet dhe lidhjet e njësisë bazë me ish të diplomuarit dhe me karrierën e tyre mbas diplomimit janë modeste.</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Institucioni si edhe nga takimet që u organizuan gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi se Institucioni, Fakulteti si edhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi nuk kryen analiza periodike të përfitimeve nga marrëveshjet.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
		X		

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Programi i studimit MP në “Administrim Biznesi” përmban lëndë sipas ligjit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lëndë bazë 2;</li> <li>- Lëndë karakterizuese 5;</li> <li>- Lëndë ndërdisiplinore dhe Lëndë integruese 3;</li> <li>- Lëndë plotësuese 1;</li> <li>- Detyrime përmbyllëse 1;</li> </ul> <p>Lendet baze dhe karakterizuese perbejne perkatesisht, 6 ECTS dhe 25 ECTS ndersa lendet nderdisiplinore dhe integruese te cilat janë 18 ne total, (midis 2 lëndëve me zgjedhje me 6 ECTS secila, zgjidhet njëra). Lënda plotësuese është praktika profesionale me 6 ECTS dhe Detyrimi përmbyllës me 6 ECTS.</p>



	<p>Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me ECTS dhe në kategoritë sipas ligjit dhe në përfundim të studimeve studentët përfitojnë 60 ECTS.</p> <p><i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit të studimit</i> <i>Tabela 9.</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Administrim Biznesi” synon vecanërisht në përgatitjen e profesionistëve në fushën e administrim biznesit</p> <p><i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit të studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Administrim Biznesi” përfshin module si Ekonomiks, Strategji Biznesi, Marketing sipërmarres, Metoda kerkimi të avancuara, Sjellje organizative që kanë si qëllim jo vetëm njohjen me teorinë, por aplikimin e tyre në praktikë, si lëndë të avancuara.</p> <p><i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit të studimit</i> <i>Tabela 9.</i></p>
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Administrim Biznesi” përfshin module që zhvillojnë njohuritë e studentëve në fushën profesionale të menaxhimit. Ky program studimi ka për qëllim të pajisë me njohuri teorike dhe praktike të diplomuarit në këtë program studimi. Gjithashtu objektivi kryesor i këtij programi është të japë njohuri mbi mekanizmat dhe marrëdhëniet financiare si edhe të pajisë studentët me aftësinë e planifikimit si edhe me kompetenca argumentuese dhe këshilluese për institucione të ndryshme në fushën e ekonomisë (<i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit të studimit</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Administrim Biznesi” përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit sic është përcaktuar nga ligji, duke përcaktuar strukturën e krediteve, orët në auditor, orët jashtë auditorit, studimin e pavarur, sipas viteve dhe semestrave.</p> <p><i>(Referenca E.1.6-Rregullore e programit të studimit)</i> <i>(Referenca Tabelat përmbledhëse: tabela 9, tabela 10).</i></p>
<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Administrim Biznesi” përmban veprimtaritë formuese të grupuar sipas kategorive të ligjit dhe me ngarkesën si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Lëndë bazë: 10% (6 kredite)</li> <li>2. Lëndë karakterizuese: 40% (24 kredite)</li> <li>3. Lëndë ndërdisiplinore: 30% (18 kredite)</li> <li>4. Lëndë plotësuese: 10% (6 kredite)</li> <li>5. Detyrime përmbyltese: 10%. (6 kredite)</li> </ol> <p>Sa më sipër janë konform ligjit në fuqi.</p>



	(Referenca Tabelat përmbledhëse: tabela 9)		
<b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	GVJ konstaton se në planin mësimor të programit MP në “Administrim Biznesi”, për praktiken profesionale, janë parashikuar 6 kredite, pesha në kredite është në përputhje me VKM nr 41.  <i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit te studimit</i> <i>Referenca- Tabelat përmbledhëse: tabela 9</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>		<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Programi MP në “Administrim Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, i cili i përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.  Departamenti i Shkencave Ekonomike e zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor. Grupi i vlerësimit të brendshëm përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit, 1 (një) anëtar i personelit akademik me kontratë (i jashtëm) dhe 1 (një) përfaqësues i studentëve të këtij program studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është një nga njësitë kryesore të Universitetit Privat “Albanian University”. Fakulteti aktualisht përbëhet nga 3 departamente:  1. Departamenti i Shkencave Ekonomike; 2. Departamenti i Art Dizajnit 3. Departamenti i Inxhinierive
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion ( <i>Referenca-Tabelat përmbledhëse: tabela 1.2</i> ) , Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike pranë Universitetit Privat “Albanian University” në vitin akademik 2021-2022, ka në përbërje të tij gjithsej <b>83 pedagogë</b> nga ku <b>38 pedagogë si Personel akademik efektiv (PAE)</b> , dhe <b>45 pedagogë me kontratë (PAK)</b> të organizuar në 3 departamente. Përbërja e departamenteve në raportet PAE / PAK është si më poshtë:
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	




	<p>Departamenti i Shkencave Ekonomike, përbëhet nga: (13 PAE / 21 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 8 / 15;</p> <p>Departamenti i Art Dizajnit, përbëhet nga: (8 PAE / 6 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 5 / 3;</p> <p>Departamenti i Inxhinierive, përbëhet nga: (17 PAE / 18 PAK), nga këta me grada/tituj shkencore 8 / 16;</p> <p>Departamenti i Shkencave Ekonomike, pjesë e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka rregulloren dhe strategjinë e vet. Drejtohet nga një përgjegjës që zgjidhet me zgjedhje të lira dhe ka personel të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë për ofrimin e programeve. Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, ka 13 personel akademik efektiv, nga të cilët me titull akademik: 1 Profesor Doktor, 2 Profesor i Asociuar dhe 5 Doktor ndërsa 5 janë me master.</p> <p><i>Nga të dhënat, GVJ evidenton që stafi akademik PAE në Departamentin e Shkencave Ekonomike, përgjegjës për këtë program studimi, është më i vogël se stafi akademik PAK i angazhuar në këtë departament (13PAE / 21 PAK).</i></p> <p><i>Referenca- Tabelat përmbledhëse: tabela 1.2</i></p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Programi MP në “Administrim Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, i cili i përmbush detyrimet ligjore për organizimin dhe stafin akademik. Ky Departament ka 9 personel akademik ndihmës për realizimin e programit.</p>						
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Programi MP në “Administrim Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Ekonomike, i cili për mbarëvajtjen dhe koordinimin në këtë program studimi ka caktuar një person përgjegjës në rolin e kordinatorit të programit të studimit. Roli i kordinatorit konsiston në koordinimin e programit, analizën e të dhënave statistikore, kontrollin raportimin dhe komunikimin me studentët për problemet e tyre.</p> <p><i>Referenca E.2.5- Miratimi i koordinatorëve për programin e studimit.</i></p>						
<p><b>Kriteri 7.</b> Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Kordinatori i programit është në kontakt të drejtpërdrejtë me përgjegjësin e Departamentit në lidhje me ecurinë e programit gjë të cilën GVJ e konfirmoi nga të dyja palët komunikuese.</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					



**Standardi II.3**

**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se për programin MP në Administrim Biznesi, njësia kryesore dhe ajo bazë disponon të gjithë dokumentacionin lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit ku përfshihen, statuti i Universitetit Privat “Albanian University”, rregullorja e Fakultetit dhe Departamentit, rregullorja e programit MP në Administrim Biznesi, plani strategjik për zhvillimin e programit, plani mësimor, syllabet lëndore etj.</p> <p><i>Referenca E.1.5- Statuti i Albanian University</i>  <i>Referenca E.2.3-Rregullore DSHE</i>  <i>Referenca E.4.2- Rregullore FSHAE</i>  <i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit te studimit</i>  <i>Referenca E.1.4-Plani Strategjik i Departamentit</i>  <i>Referenca E.2.2-Syllabuse</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktike e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit MP në Administrim Biznesi përmban veprimtaritë formuese të grupuar sipas kategorive të ligjit dhe me ngarkesën si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Lëndë bazë: 10% (6 kredite)</li> <li>2. Lëndë karakterizuese: 40% (24 kredite)</li> <li>3. Lëndë ndërdisiplinore: 30% (18 kredite)</li> <li>4. Lëndë plotësuese: 10% (6 kredite)</li> <li>5. Detyrime përmblylles: 10%. (6 kredite)</li> </ol> <p>Sa më sipër janë konform ligjit në fuqi.  <i>Referenca Tabelat përmbledhëse: tabela 9</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Të gjitha lëndët janë të vlerësuara me ECTS dhe në kategoritë sipas ligjit dhe në përfundim të studimeve studenti përfiton 60ECTS.</p> <p><i>Referenca Tabelat përmbledhëse: tabela 9</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Programi i studimit MP në Administrim Biznesi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit sic është përcaktuar nga ligji, duke përcaktuar strukturën e krediteve, orët në auditor, orët jashtë auditorit, studimin e pavarur, sipas viteve dhe semestrave si dhe frekuentimin dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Skema e vlerësimit është e njëjtë në të gjitha lëndët. Mënyra e vlerësimit është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● provimi i ndërmjetëm (20%)</li> </ul>






	<ul style="list-style-type: none"> <li>• provimi përfundimtar (60%)</li> <li>• detyrat e kursit/prezantim/punë në grup (10%)</li> <li>• pjesmarrja aktive në seminar (10%)</li> </ul> <p><i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit te studimit.</i></p>								
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Programi i studimit MP në Administrim Biznesi ka rregulloren e vet ku përfshihet i gjithë informacioni i nevojshëm për studentët në lidhje me pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve në nenet 10-13.</p> <p><i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit te studimit.</i></p>								
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Programi i studimit MP në Menaxhim Bankar dhe Financiar përmban të gjithë informacionin lëndor dhe praktikatat që lidhen me të si dhe të gjithë elementët formues të programit sipas kërkesave të ligjit dhe rregulloreve të brendshme të Fakultetit.</p> <p>GVJ nga shqyrtimi i syllabuseve, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për format e organizimit, mënyrën e vlerësimit etj. GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar.</p> <p><i>Referenca E.2.2-Syllabuse</i></p>								
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	<p>Nga intervista GVJ konstatoi se programi lëndor (syllabet) diskutohen në fillim të cdo viti akademik dhe dokumentacioni firmoset nga titullari i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit.</p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						


#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Programi i studimit MP në Administrim Biznesi është strukturuar me module 3, 4, 5, dhe 6 ECTS. Në përfundim të studimeve studenti fiton 60 ECTS. Programi është në përputhje me ligjet në fuqi.</p> <p><i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit te studimit.</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive kryesisht mundësojnë thellimin e njohurive të fushës së menaxhimit dhe administrimit</p> <p><i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit të studimit.</i></p> <p><i>Referenca E.2.2-Syllabuse</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Sipas planit mësimor të programit është përcaktuar se shpërndarja e moduleve është 6 lëndë semestrin e parë dhe 4 në semestrin e dytë. Në semestrin e dytë gjithashtu zhvillohet edhe praktika profesionale si edhe punimi I diplomës.</p> <p>Vlerësimi i lëndëve në kredite e mundëson arritjen e objektivave të programit.</p> <p><i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit të studimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit me të gjitha elementët që e shoqërojnë janë në përputhje me profilin e programit. Në lidhje me programet e tjera ndërkombëtare GVJ mendon se përafrimi ndërkombëtar duhet të jetë në fillim gjeografik rajonal në Ballkan dhe Europë, gjë të cilën nuk e konfirmon në këtë rast.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese ndjek kërkesat ligjore, GVJ evidenton se raporti teori praktikë favorizon më tepër praktikën në mënyrë që të arrihen objektivat e programit por edhe në funksion të punësimit.</p> <p><i>Referenca E.2.2-Syllabuse</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Syllabet e lëndëve ndjekin procesin e përditësimit cdo vit akademik, fakt i konfirmuar nga stafi i Departamentit dhe nga përgjegjësi i saj. GVJ në rishikim të dokumentacionit vëren se syllabet lëndore kanë të përditësuar literaturën e tyre sipas kërkesave ligjore në lidhje me 5 vitet e fundit.</p> <p><i>Referenca E.2.2-Syllabuse</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ gjykon nga përmbajtja e programeve të lëndëve se për këtë nivel studimi të ciklit të dytë se disa nga lëndët janë të mbi ngarkuara me tematika dhe koncepte bazë psh <i>Sistemet e Informacionit në Menaxhim</i> dhe <i>Metoda kërkimi të avancura</i>.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Duke marrë parasysh dhe sa janë përmendur në kriteret e mësipërme, GVJ gjykon se ky program ofron njohuri, aftësi dhe kompetenca të thelluara profesionale</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje</p>	<p>GVJ gjykon se përmbajtja e programit e mundëson ecurinë e studentëve në studime të mëtejshme si edhe duke u bazuar te studimi i tregut të punës një pjesë e mirë e studenteve janë</p>






me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	punësuar, cka bën të vlerësohet se ka një përqindje të lartë përshtatje me pritshmëritë e tregut të punës.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se personeli akademik i përmbush kërkesat ligjore në fuqi; pedagogët që mbulojnë nevojat e programit janë me titull Prof.Dr, Prof. Asoc, Dr, Dr në proces por edhe me titullin Msc por me ekspertizë dhe eksperiencë pune ne fuhsën përkate të mësimdhënies përvec njërit i cili është me gradë kandidat doktorant.  <i>Referenca E.2.9-CV Stafi Akademik 1 (1).</i> <i>Referenca E.2.9-CV Stafi Akademik 1 (2).</i> <i>Referenca-Tabela 1.2</i>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	GVJ konstaton se programi MP në “Administrim Biznesi” mbulohet me staf akademik efektiv dhe staf akademik me kontratë. Në bazë të të dhënave për vitin akademik 2021-2022, (tabela 12.1; 12.2; 12.3), modulet e ofruara janë mbuluar 6/11 lëndë me pedagogë të jashtëm dhe 5 module nga pedagogë të brendshëm.  Për vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar <b>10 pedagogë (7 PAE / 3 PAK):</b> - 2 Prof.Asoc; - 6 Dr; - 2 Msc; Mbulimi i programit në përqindje është <b>78.6 % PAE.</b>  Për vitin akademik 2020-2021 janë angazhuar <b>11 pedagogë (7 PAE / 4 PAK):</b> - 2 Prof.Asoc; - 6 Dr; - 3 Msc; Mbulimi i programit në përqindje është <b>63.4% PAE.</b>



	<p>Për vitin akademik 2021-2022 janë angazhuar <b>10 pedagogë (4 PAE / 6 PAK):</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 Prof. Dr</li> <li>- 1 Prof.Asoc;</li> <li>- 5 Dr;</li> <li>- 4 Msc;</li> </ul> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>36% PAE</b></p> <p><i>GVJ nga të dhënat e vëna në dispozicion, evidenton një tendecë në rënie për mbulimin e programit në përqindje nga stafi akademik efektiv.Për vitin akademik 2021-2022 mbulimi i programit përmbush raportin 75% PAE / 25 % PAK.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në Institucion, GVJ konstatoi se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p> <p><i>Referenca E.2.9-CV Stafi Akademik 1 (1).</i> <i>Referenca E.2.9-CV Stafi Akademik 1 (2).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion dhe marrëveshjeve në fuqi si dhe nga takimi me studentët, Universiteti Privat “Albanian University” ofron mundësinë për të udhëzuar studentët në praktikën e tyre profesionale. Duke qenë se një pjesë e studentëve janë të punësuar, në pjesën më të madhe institucioni ofron mbështetje në lidhje me temën e diplomës.</p> <p>Në dokumentacionin e paraqitur nga insticioni përshkruhen me hollësi procedurat e zhvillimit të praktikës si dhe udhëzimet për punimin e diplomës.</p> <p><i>Nga takimi që GVJ pati me studentët e këtij programi studime, u evidentua se studentet nuk ishin të gjithë të qartë dhe nuk e kishin filluar në kohë ose ende punën përgatitore për punimin e diplomave.</i></p> <p><i>Reference E.3.11-Rregullore e punimit te Temes se Diplomes.</i> <i>Reference E.5.1-Liste e Temave te Diplomave</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera</p>	<p>Ky kriter nuk është i aplikueshëm 100% për programin në fjalë. Universiteti Privat “Albanian University” ofron hapësira dhe laboratorë të pajisur me kompjutera, të cilët përdoren për lëndë të caktuara</p>





mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
		X	

### Standardi II.6

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Riorganizimi i programit MP në Administrim Biznesi dhe Financiar është kryer në vitin 2018 duke kaluar kështu nga 90 kredite në 60 kredite.  <i>Por nga dokumentacioni I vënë në dispozicion si edhe nga takimet që GVJ pati në Institucion nuk ka patur rishikim të kurrikulës dhe në të nuk janë përfshirë propozime nga aktorë nga biznesi apo aktorë të tjerë të tregut të punës.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Nëpërmjet NJSBC institucioni ka filluar procesin e përfshirjes së studentëve në përmirësimin e programeve. Kjo kryhet nëpërmjet pyetësoreve që Drejtorja ka hartuar dhe analizon. Gjithsesi është akoma në fazë primare për të përcaktuar nëse reflektimi i propozimeve të studentëve në lidhje me programin e studimit është kryer për shkak të evidencave të pa mjaftueshme në lidhje me këtë.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Institucioni ka kryer një studim për tregun pas diplomimit, iniciativë të cilën GVJ e konsideron shumë të vlefshme në lidhje me vendimet strategjike në lidhje me programin por edhe me koordinimin administrativ të tij.  Paralelisht Zyra e ALUMNI dhe Këshillimit të Karrierës e krijuar në Universitet ka ndërmarë një nisëm për gjurmimin e studentëve të diplomuar në mënyrë që të krijohet një databazë me këta studentë. GVJ njeherë përpjekjen e institucionit për të përmbushur këtë kriter.
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Gjatë Vizitës që GVJ pati në Institucion me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si edhe me Përgjegjësin e Departamentit të Shkencave Ekonomike, evidentoi se Fakulteti dhe Departamenti po ideonin hapjen e një programi të ri studimi në fushën e titujve financiarë si një nevojë e paplotësuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë në vend në këtë fushë dhe si një kërkesë dhe domosdoshmëri për kompanitë në këtë fushë.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

23



Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Zhvillimi i procesit mësimor realizohet sipas metodave klasike. Në këtë institucion të arsimit të lartë janë adaptuar sistemet e mësimdhënies dhe të vlerësimit të vazhduar me një ndarje prej:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● provimi i ndërmjetëm (20%)</li> <li>● provimi përfundimtar (60%)</li> <li>● detyrat e kursit/prezantim/punë në grup (10%)</li> <li>● pjesmarrja aktive në seminar (10%)</li> </ul> <p>GVJ konstatoi se Universiteti Privat “Albanian University” nxit zhvillimin e përdorimit të metodave interaktive dhe inovative të mësimdhënies. Stafi akademik është pjesë e marrëveshjeve të mobilitetit të cilat janë zbatuar edhe për stafin e fakultetit me synim rritjen profesionale të tyre nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me institucionet e huaja. Për më tepër ngritja e komisioneve të sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti dhe rregullorja e NJSBC monitoron rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Nga takimi me stafin akademik dhe me studentet, GVJ konstatoi se përdorimi i metodave interaktive përfshinte ushtrime praktike të kontabilitetit, balance apo case study nga realiteti për t’i bërë modulet sa më praktike.</p>



**Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.

Departamenti ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik.

Nuk rezulton që të perdoren vlerësime të diferencuara midis pedagogësh dhe që synojnë stimulimin dhe inkurajimin e pedagogëve që aplikojnë metoda të reja dhe bashkëkohore.

Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës në bashkërendim me NJSBC nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuara nga studentët (*Referenca E.3.1.a-Pyetesoret e studenteve*). Vlerësimi i performancës kryhet në fund të cdo viti akademik, ndërsa pyetësi me studentët realizohet para provimeve dhe rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Gjithashtu NJSBC zhvillon edhe grup fokus të studentëve me pjesëmarrje të një numri të vogël studentësh për cdo program studimi dhe që zgjidhen në mënyrë rastësore. Mendimet dhe sygjërimet e marra nga këto grupe fokusi, NJSBC ja vë në dispozicion përgjegjësit të departamentit përkatës, i cili edhe jep përgjigje për marrjen në konsideratë apo apo vënien në zbatim të sygjërimeve (*Referenca E.3.1.b-Fokus-Grupe*).

Vlerësimi i stafit akademik gjithashtu bëhet për cdo vit akademik nga përgjegjësi i departamentit (*Referenca E.3.3-Raport Vetevleresimi*). Vëtë Institucioni realizon pyetësor për të ditur mendimet dhe sygjërimet e stafit mësimdhënës si edhe atë ndihmës në lidhje me mësimdhënien, por jo vetëm (*Referenca E.3.1.c-Pyetesoret e personelit akademik dhe administrativ*)

**Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.

Departamenti dhe fakulteti organizojnë rregullisht metoda të përfshirjes së studentëve në vlerësimin e formave, metodave dhe nivelit të mësimdhënies. Forma më e përdorur për këtë ka qënë organizimi i anketave dhe pyetësorëve, të cilët përpilohen në bashkëpunim me zyrën e kontrollit të cilësisë. GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet dhe pyetësorëve (*Referenca E.3.1.a-Pyetesoret e studenteve*), si edhe paraqitjes së ankesave kundrejt pakëkanqësive të tyre lidhur me format e vlerësimit (*E.1.6-Rregullore e programit të studimit. Neni 24*).



	Sipas konstatimit të GVJ rezultatet e pyetësorëve bëheshin të ditura për departamentin nga NJSBC për cdo semestër.			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Zyra përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë që është ngritur dhe funksionon në nivel universiteti, harton raporte dhe i bën ato objekt diskutimi dhe analiza në senatin akademik. Gjithashtu për departamentin përgjegjës për këtë program studimi janë caktuar 2 pedagogë të cilët ndjekin çështjet e cilësisë në nivel departamenti ( <i>Referenca E.6.3.c-Grupet e Cilesise 2021-2022</i> ). Paralelisht njësia bazë dhe kryesore (Departamenti dhe Fakulteti) bëjnë publike rezultatet në analizën vjetore të njësisë. Këto rezultate fillimisht diskutohen në një mbledhje të hapur departamenti. Vetëm pas diskutimeve në Departament dhe reflektimeve të ndryshme lidhur me problematikat e gjetura, kjo analizë miratohet dhe përcillet në Dekanat.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion evidentohet se Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi përdorin mënyra për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Pyetësori i studentëve përdoret si mjet për të evidentuar dhe vlerësuar shembuj të mirë dhe efikas në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Rastet e specifikuar si pozitive nga studentët bëhen të ditura në mbledhjet e departamentit, sic na është konfirmuar edhe në takimet me përgjegjësen e Departamentit. Por në analizat vjetore të programit apo të procesit të mësimdhënies së Departamentit të Shkencave Ekonomike që mbulon këtë program, nuk ka të dokumentuar raste të diferencuara, shembuj të praktikave të mira apo emra pedagogësh apo lëndësh që duhen promovuar dhe inkurajuar, që janë të mirëvlerësuar dhe që janë për këtë shkak të diferencuar nga pjesa tjetër e stafit.  ( <i>Referenca E.3.1.a-Pyetesoret e studenteve</i> ) ( <i>Referenca E.3.1.c-Pyetesoret e personelit akademik dhe administrativ</i> )			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

#### Kriteret

**Vlerësimi i ekspertëve**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



**Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.

Në lëndët dhe modulet e këtij program studimi përdoren format klasike të mësimdhënies, të gërshetuara midis tyre, si leksionet, seminarët, ushtrimet, punimet e kursit, punët e pavarura, praktikë profesionale, tema diplome (*Statuti Universiteti Privat "Albanian University", Rregullore e Pergjithshme e AU, neni 41, Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, neni 32; Rregullore e programit të studimit, neni 7*).

Programi përfshin 60 kredite në total nga të cilat 30 fitohen në semestrin e parë, 18 në semestrin e dytë, 6 praktika profesionale dhe 6 mikroteza të cilat gjithashtu janë në semestrin e dytë.

Orët/kreditet e këtij cikli studimesh janë:

612 orë Orë në auditor;

888 Orë jashtë auditorit;

1500 orë-60 kredite Totali;

Praktikë profesionale: 6 kredite

Detyrime përmbyllëse-Mikroteza: 6 kredite

*Bazuar në dokumentacion (tabela 10-Plani mësimor), orët mësimore në auditor në javë janë 20 orë/javë, pra mesatarisht 4 orë mësimi në ditë. Gjatë takimit që CVJ pati me studentët e këtij programi studimi, u konstatua se mësimi*

**Kriteri 2.** Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.

Në lëndët dhe modulet e këtij program studimi përdoren format klasike të mësimdhënies, të gërshetuara midis tyre, si leksionet, seminarët, ushtrimet, punimet e kursit, punët e pavarura, praktikë profesionale, tema diplome (*Statuti Universiteti Privat "Albanian University", Rregullore e Pergjithshme e AU, neni 41, Rregullore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, neni 32; Rregullore e programit të studimit, neni 7*).

Programi përfshin 60 kredite në total nga të cilat 30 fitohen në semestrin e parë, 18 në semestrin e dytë, 6 praktika profesionale dhe 6 mikroteza të cilat gjithashtu janë në semestrin e dytë.

Orët/kreditet e këtij cikli studimesh janë:


612 orë Orë në auditor;

888 Orë jashtë auditorit;

1500 orë-60 kredite Totali;



	<p>Praktikë profesionale: 6 kredite</p> <p>Detyrime përmbyllëse-Mikroteza: 6 kredite</p> <p><i>Bazuar në dokumentacion (tabela 10-Plani mësimor), orët mësimore në auditor në javë janë 20 orë/javë, pra mesatarisht 4 orë mësimi në ditë. Gjatë takimit që GVJ pati me studentët e këtij programi studimi, u konstatua se mësimi në auditor zhvillohej cdo ditë 3 orë mësimi, pra në javë 15 orë mësimore. Në këtë mënyrë ka një mospërputhje mes orëve mësimore në auditor të deklaruara në planin mësimor dhe orëve mësimore të realizuara në auditor.</i></p> <p>Në procesin mësimor janë aplikuar edhe ftesa për personal akademik të jashtëm apo për personalitete të fushës të cilët kanë ofruar leksione të hapura dhe kanë sjellë në auditor eksperiencat e tyre apo të institucionave që kanë drejtuar (Referenca E.3.4-Leksione te Hapura)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Ne kuadrin e mbështetjes të procesit të mësimdhënies, stafi akademik, ka mundësi të përdorë mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive.</p> <p>Institucioni npm NJSBC, vazhdimisht organizon trajnime të karakterit pedagogjik dhe psikologjik për stafin akademik si dhe atë ndihmës apo administratë për mbarëvajtjen e të gjithë procesit mësimor (Referenca E.3.5 -Agjenda e Trajnimeve te personelit akademik-19-20; Referenca E.3.5.a -Agjenda e Trajnimeve te personelit adm-21-22).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi plotëson kryesisht kriteret ligjore të kualifikimit, pasi ka lektorë të cilët janë ende në proces doktorature. Në kontrollin rastësor që GVJ kreu për dosjet e personelit u vërejt përputhje e profilit të lëndës me specialitetin e pedagogut. Personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive. Ata kanë fituar një eksperiencë të kënaqshme, janë relativisht të rinj dhe kjo përbën një avantazh të dukshëm.</p> <p>Një pjesë e këtij personeli janë të angazhuar në proces mësimdhënës edhe në universitete të tjera brenda vendit dhe kjo përbën pa asnjë dyshim një avantazh të dukshëm dhe progres të evidentueshëm.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni i jep rëndësi zhvillimit me korrektësi të procesit mësimor nga ana e pedagogëve. Institucioni, kryesisht njësia bazë/Departamenti, vlerëson format e mësimdhënies dhe</p>






	<p>analizon performancën e këtij procesi. Për këtë Departamenti, si strukturë që drejton programin, analizon periodikisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Cdo vit akademik bën një analizë të procesit mësimor dhe pedagogjik;</li> <li>• Analizon dhe diskuton përfshirjen e pedagogëve në kërkimin shkencor;</li> <li>• Realizon dhe tërheq opinionin e studentëve lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies;</li> </ul> <p>Kontrollet e vazhdueshme dhe leksionet e hapura të organizuara nga departamenti, identifikojnë problemet që duhen përmirësuar dhe vlerësojnë arritjet. Pjesë e reflektimit dhe organizimit të leksioneve të hapura janë edhe rezultatet e marra nga pyetësi i studentëve</p>						
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Personeli akademik përdor diskutime të lira dhe metoda të tjera interaktive në orët e mësimin që synojnë përfshirjen dhe gjallërimin e shprehjes së lirë të ideve dhe të inkurajimit të studentëve për të përfituar nga ky diskutim.</p> <p>Nga vizita ne institucion mësuam se personeli akademik përpiqet që të angazhojë studentët me diskutime brenda fushës së lëndës apo realizojnë konkurse dhe vizita studimore, për ta bërë më tërheqëse orën e mësimin, të përdorë case study, apo të përfshijë raste nga tregu lokal.</p>						
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Programi i studimit, i nivelit master profesional, i është larguar formës klasike së mësimdhënies. Programi ka karakter sa teorik po aq edhe praktik dhe profesional. Studentët nxiten shumë për punë të pavarur. Midis pedagogëve dhe studentëve dominon respekti i ndërsjellë dhe reciprok si dhe fryma e ndërtimit të marrëdhënieve të ngrohta dhe komunitare. Ne kuadrin e mbështetjes të procesit të mësimdhënies, stafi akademik, ka mundësi të përdorë mjete bashkëkohore të mësimdhënies siç janë mjetet audio-vizive.</p> <p>Institucioni npm NJSBC, vazhdimisht organizon trajnime të karakterit pedagogjik dhe psikologjik për stafin akademik si dhe atë ndihmës apo administratë për mbarëvajtjen e të gjithë procesit mësimor (<i>Referenca E.3.5 -Agjenda e Trajnimeve te personelit akademik-19-20; Referenca E.3.5.a -Agjenda e Trajnimeve te personelit adm-21-22</i>).</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="632 1794 788 1861">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="788 1794 995 1861">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="995 1794 1203 1861">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="632 1861 788 1910"></td> <td data-bbox="788 1861 995 1910"></td> <td data-bbox="995 1861 1203 1910">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					



**Standardi III.3**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga vizita që GVJ pati në Institucion, evidentoi se godina e Universitetit Privat “Albanian University” që përdorej edhe për këtë plan studimi, mundëson që procesi mësimor e shkencor për të gjitha programet e studimeve të zhvillohet brenda të gjithë parametrave moderne. Sipas orarit të mësimit semestral, studentët zhvillojnë mësimin (leksione dhe seminare) në mjedise të mjaftueshme për numrin e studentëve, të grupeve mësimore dhe në përputhje me specifikën që kanë lëndët dhe modulet e këtij programi studimi. Ajo është e pajisur me mjete për ndriçim alternativ, rezerva të konsiderueshme uji, sistem kondicionimi gjatë gjithë vitit i shtrirë në të gjitha ambientet, internet, vende çlodhjeje e qëndrimi, sistem mbrojtjeje nga zjarri, shërbim, etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë. Sallat e leksioneve janë të pajisur me kompjutera e projektorë. Godina e Universitetit Privat “Albanian University” ku zhvillon mësimin ky program studim dhe ambientet ku zhvillohet mësimi plotësojnë të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m<sup>2</sup> / student.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University” ka pajisur zyrat e personelit akademik të cilat ofrojnë kushtet e nevojshme nga pikëpamja infrastrukturë për të realizuar punën e tyre akademike, dhe procesin mësimor, kjo e paraqitur në RVB në nivele të larta integrimi të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit edhe nëpër auditore. Nga vizita në godinë dhe gjatë diskutimeve me grupe të ndryshme, GVJ iu referua se pika të forta në department mbeten logjistika IT e programet kompjuterike. Gjithashtu, sic e përmendëm edhe më sipër, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisur me kompjutera e projektorë.</p>






<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura bazë për çdo modul të ofruar në këtë program studimi ofrohet në gjuhën shqipe. Baza mësimore përfshin tekste mësimore, cikle leksionesh, leksione në ppt. Biblioteka ofron tituj bazë dhe materiale mbështetëse në shqip si edhe në gjuhë të huaj (<i>Referenca E.3.6-Lista e Librave</i>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka vë në dispozicion të studentëve nëpërmjet teksteve mësimore të përcaktuara në syllabuse-t e lëndëve dhe literaturë ndihmëse të nevojshme, përzgjedhur mbi bazë të planit të hartuar nga përgjegjësi i programit (<i>Referenca E.4.4-Model Kartele Biblioteke</i>).</p> <p>GVJ evidentoi që fondi i bibliotekës, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, pasurohet në mënyrë të vazhdueshme, duke synuar reflektimin e ndryshimeve cilësore të programit të studimit si edhe azhornimin me zhvillimet më të fundit të literaturës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (<i>Referenca E.3.7-Procedure blerje libra</i>).</p> <p>Nga vizita në Institucion, nga takimi që GVJ pati edhe me studentët, rezultoi që <i>biblioteka nuk përdoret shumë nga studentët për shkak të mos përputhjes së orarit të mësimit të studentëve (17.00-20.00) dhe orarit të bibliotekës (çdo ditë 8.00-16.00 dhe të shtunë 8.00-12.00).</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB-së theksohej për aksesin në librarinë online, por kjo rezultoi se nuk përdoret nga studentët me të cilët GVJ zhvilloi takimin.</p> <p>Universiteti përfshihet në Bibliotekën Dixhitale të mundësuar nga RASH.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University” ka salla konferencash dhe ambiente studimi në bibliotekë të cilat janë në funksion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit, diplomave apo edhe prezantimin e tyre. Gjithashtu në funksion të mësimdhënies dhe zhvillimit bashkëkohor të saj, është edhe një laborator i teknologjisë së informacionit. Studentët po ashtu kanë specifikuar se nuk i përdorin laboratorët në funksion të përmbushjes së detyrave të tyre (projekte apo detyra kursi), kjo edhe për shkak të mospërthutjes së orareve.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Stafi akademik i Universitetit Privat “Albanian University”, zhvilloi mësimin online gjatë periudhës së COVID-19, semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020 dhe gjithë vitin akademik 2020-2021 duke përdorur platformën Teams (<i>Referenca E.3.8-Model klase online Teams</i>)</p>



<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Komunikimi i brendshëm mes stafit akademik dhe studentëve, bëhet nrm platformës Teams ose adresave të emailit.</p>		
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të propozojë sipas dëshires se tij tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë (ose të zgjedhë ndër temat që pedagogët udhëheqës kanë propozuar në Departament), të zgjedhë udhëheqësin e tij dhe në bashkëpunim më të, të përcaktojë temën kërkimore që do të realizojë për mbrojtje (<i>Referenca E.5.1-Liste e Temave te Diplomave</i>). Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale. Tezat e diplomës dhe pedagogët që do të udhëheqin punimin e tyre, përcaktohen nga departamenti. Refereuar RVB, studentët zgjedhin temën 1 diplomës dhe pedagogun udhëheqës një muaj nga fillimi i vitit akademik.</p> <p><i>Por nga takimi me studenët e këtij programi studimi, GVJ evidentoi se, edhe pse diplomimi ishte pas një muaji nga takimi, kishte studentë që ende nuk kishin zgjedhur temën, pedagogun udhëheqës apo nuk kishin komunikuar me pedagogët udhëheqës.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi III.4</b> <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimaxënies në programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që nga muaji Korrik 2010, është përgjegjëse për të siguruar cilësinë e programeve të studimit në Universitetin Privat “Albanian University” dhe përmirësuar vazhdimisht mësimdhënien (<i>neni 14 i rregullores së Universitetit Privat “Albanian University”</i>). Gjithashtu për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe kurrikulave, në Institucion funksionojnë edhe Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave si edhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin (<i>Referenca E.1.3-Rregullore e Përgjithshme e AU, Neni 14, 15, 16</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli</p>	<p>Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për këtë program studimi, ndjek rregullisht ecurinë e procesit mësimor dhe</p>






<p>akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>monitoron rregullisht aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe pedagogjik.</p> <p>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik kryhet në mënyrë periodike nga departamenti dhe fakulteti përkatës në bashkërendim me NJSBC nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre dhe nëpërmjet rezultateve të pyetësoreve të plotësuara nga studentët (<i>Referenca E.3.1.a-Pyetesoret e studenteve</i>). Vlerësimi i performancës kryhet në fund të cdo viti akademik, ndërsa pyetësori me studentët realizohet para provimeve dhe rezultatet e anketimit të përpunuara bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe kryesore. Gjithashtu NJSBC zhvillon edhe grup fokus të studentëve me pjesëmarrje të një numri të vogël studentësh për cdo program studimi dhe që zgjidhen në mënyrë rastësore. Mendimet dhe sygjerimet e marra nga këto grupe fokusi, NJSBC ja vë në dispozicion përgjegjësit të departamentit përkatës, i cili edhe jep përgjigje për marrjen në konsideratë apo apo vënien në zbatim të sygjerimeve (<i>Referenca E.3.1.b-Fokus-Grupe</i>).</p> <p>Vlerësimi i stafit akademik gjithashtu bëhet për cdo vit akademik nga përgjegjësi i departamentit (<i>Referenca E.3.3-Raport Vetevleresimi</i>). Vetë Institucioni realizon pyetësor për të ditur mendimet dhe sygjerimet e stafit mësimdhënës si edhe atë ndihmës në lidhje me mësimdhënien, por jo vetëm (<i>Referenca E.3.1.c-Pyetesoret e personelit akademik dhe administrativ</i>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Leksionet e hapura nga lektorë të ftuar të huaj dhe vendas të organizuara në Universitetin Privat “Albanian University”, pjesëmarrja e stafit akademik në projektet e mobilitetit me universitetet e huaja, konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, Konferenca Studentore e organizuar me mbështetjen e stafit akademik, kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Aktivitetet kërkimore-shkencore të pedagogëve duke përfshirë edhe studentët në Konferenca Studentore, zenë një vend të rëndësishëm në fokusin e aktiviteteve të Universitetit Privat “Albanian University”, me objektiv të drejtpërdrejtë rritjen e cilësisë së dijeve të studentëve. Rritja e nivelit shkencor individual të pedagogëve nëpërmjet botimeve të ndryshme shkencore, pjesëmarrjes në konferenca brenda dhe jashtë vendit transmeton në procesin mësimor sinjale të rëndësishme të</p>



	<p>kërkesave të tregut dhe aktualizon dijen në çdo fushë studimi. Kjo gjë konfirmohet dhe në CV e stafit akademik që shikohet se në këto vitet e fundit kanë rritur nivelin e kualifikimit në fushën e kërkimit shkencor. Ky kualifikim i personelit akademik të Fakultetit dhe Departamentit ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e mëtejshëm të procesit të mësimdhënies.</p> <p><i>Referenca E.1.8- Konferenca studentore</i>  <i>Referenca E.2.11-Postera Konferenca</i>  <i>Referenca E.2.9-CV Stafit Akademik 1&amp;2</i>  <i>Referenca E.3.1.d-Tabela per kerkimin shkencor</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në vazhdimësi personeli akademik i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamentit të Shkencave Ekonomike, kualifikohen brenda institucionit, në zbatim të udhëzuesit të stafit akademik si dhe në kuadër të marrëveshjeve me institucione të tjera homologe përmes trajnimeve, diskutimeve, leksioneve të hapura i kanë shërbyer trjanimit të stafit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe të metodave të reja në mësimdhënie.</p> <p><i>Referenca E.3.4-Leksione te Hapura.</i>  <i>Referenca E.3.5-Agjenda e Trajnimeve te personelit akademik 19-20</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Ka qënë dhe është në përgjegjësinë e personelit akademik zbatimi i programeve të studimit si dhe transmetimi i metodave të reja në mësimdhënie dhe praktikave mësimore tek studentët. Pedagogu është përgjegjës për të gjitha zërat e detyrave që ai ka në marrëdhënie me studentët për organizimin dhe zhvillimin e mësimin si dhe plotësimin e detyrave që i ngarkon departamenti.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedat e zhvilluara me pedagogët u konstatua qartë vullneti i strukturave drejtuese për t'u siguruar atyre si informacionin e nevojshëm për programe të ndryshme studimi, me qëllim kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Universiteti Privat "Albanian University" ka një sërë marrëveshjes dhe parteritete me Institucione të Arsimit të Lartë në vend dhe jashtë duke zhvilluar herë pas here edhe leksione të hapura. Ky angazhim ka ndihmuar në rrjetizimin e universitetit dhe krijimin e vazhdimësisë së bashkëpunimit me institucionet partnere (<i>Referenca- Tabelat përmbledhëse, tab.5</i>).</p>





Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi III.5

**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ mendon se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e studentëve. Konkretisht, në përputhje me parashikimet në syllabuse, metodat e vlerësimit përfshijnë testimet, detyra kursi, si dhe provime përfundimtare. Format e kriteret e vlerësimit të dijeve për studentët janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit dhe në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së Universitetit Privat “Albanian University” realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegjumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës;</li> <li>- detyrave të kursit për problematikën e disiplinës;</li> <li>- provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës;</li> </ul> <p>Skema e vlerësimit është e njëjtë në të gjitha lëndët. Mënyra e vlerësimit është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● provimi i ndërmjetëm (20%)</li> <li>● provimi përfundimtar (60%)</li> <li>● detyrat e kursit/prezantim/punë në grup (10%)</li> <li>● pjesmarrja aktive në seminar (10%)</li> </ul> <p>Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve (<i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit te studimit</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e</p>	<p>Nga dokumentacioni dhe vizita ne institucion konstatoam se pedagogu i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerës të syllabusit. Gjithashtu i njeh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës, studentët informohen rregullisht, në fillim</p>



<p>lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>të cdo semestri dhe përgjatë tij lidhur me lëndët, me syllabusat e cdo lënde dhe me kërkesat e programit për studentët. Ata njohin detyrimet e tyre dhe kohën e përmbushjes së këture detyrimeve.</p> <p>Bazuar në rregulloret e studimeve të Universitetit Privat “Albanian University”, si edhe rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar edhe format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që i ka përvetsuar studenti gjatë zhvillimit teroik e praktik të lëndës/modulit si aktivizim në mësim, si testimi i ndërmjetëm/detyrat e kontrollit, detyrat e kursit dhe provimi final. Vlerësimi dhe testimi i njohurive realizohet në forma të ndryshme të tilla si: vlerësimi me punime të pavarura, ose detyra kursi, një kontroll ose vlerësim të pjesshëm si edhe vlerësimi përfundimtar.</p> <p>Tezat e provimit dhe të kontrollit janë gjithëpërfshirëse dhe mesatare. Grafikët e provimeve shpallen para fillimit të sezonit. Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit te studimit.</i>  <i>Referenca E.1.3-Rregullore e Pergjithshme e AU.</i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="606 1097 766 1164">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="766 1097 973 1164">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="973 1097 1181 1164">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="606 1164 766 1254"></td> <td data-bbox="766 1164 973 1254"></td> <td data-bbox="973 1164 1181 1254">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					


<b>Standardi III.6</b> <b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Nga verifikimet u konstatua që vlerësimi i njohurive, aftësive dhe dijeve të studentit realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe studentët janë njohur për të në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e Departamentit. Ky vlerësim ndahet në dy pjesë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit;</li> <li>2. Vlerësimi përfundimtar;</li> </ol> <p>Këto programe miratohen çdo vit nga përgjegjësi i departamentit.</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Institucioni si edhe nga vizita në Institucion, GVJ nuk evidentoi përdorim të ndonjë sistemi elektronik për testimin apo edhe vlerësimin. Provimet me shkrim sekretohen në momentin e zhvillimit të provimit dhe hapen (csekretohen) në Departament. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore.</p> <p><i>Sugjerohet përdorimi i një sistemi elektronik për të rritur transparencën në vlerësim.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Komisionet e provimeve përbëhen së paku nga 2 anëtarë ku njëri prej tyre është pedagogu apo lektori i lëndës dhe tjetri asistenti ose një pedagog që ka të njëjtin profil ose të përafert.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Provimet me shkrim sekretohen në momentin e zhvillimit të provimit dhe hapen (csekretohen) në Departament. Pikët e akumuluar dhe vlerësimi përfundimtar janë transparente tek studentët. Nëse ka ndonjë ankesë, studentët drejtohen në njësinë bazë të cilët ndjekin procedurën e përcaktuar në rregullore.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimi me studentët u informuam që ata që në fillim të lëndës orientohen nga pedagogët në lidhje me programin e lëndës dhe detyrimeve të saj, me testimet e ndërmjetme, me pikët që i korespondojnë atyre, me strukturën e detyrave e projekteve të kursit. Në vazhdim ata instruktohen me menyrën se si do të realizojnë këtë detyrë kursi apo projekt, i cili në fund të lëndës apo modulit prezantohet nga studentët para kursit të tyre dhe pedagogut të modulit. Një procedurë e tillë mundëson marrjen e feedback-ut si nga pedagogu ashtu dhe nga studentët e tjerë në lidhje me aspektet pozitive të punimit apo elementët që kanë nevojë për përmirësim apo detajim të mëtejshëm. Ky proces ballafaqimi me një audiencë të caktuar ndihmon studentët të përmirësohen në drejtim të mësimnxënies si dhe të fitojnë/përmirësojnë aftësitë e tyre prezantuese.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Komisionet e provimit përbëhen nga të paktën dy pjestarë të stafit akademik të miratuar sipas përcaktimit të rregulloreve. Hartimi i tezave të reja bëhet për çdo sezon provimi. Personelit akademik që ndjek procesin e provimit u ndalon hyrjen në provim personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të Universiteti Privat “Albanian University”. Studentëve nuk u lejohet mbajtja</p>



	dhe përdorimi i celularëve në provim. Studentët që në provim përdorin forma e mjete të palejueshme përjashtohen nga provimi. Përsa i përket temave të diplomave udhëheqësi mban kontakte të vazhdueshme me studentin si dhe i kërkon informacion të detajuar për literaturën e përdorur në secilën nga pjesët e punimit dhe mënyrën e referimit të saj.		
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Proçesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në përputhje me programin e studimit. Rezultatet e provimit i vihen në dispozicion sekretarisë mësimore brenda 7 ditëve kalendrike nga data e kryerjes së provimit, e cila njofton studentët individualisht për rezultatin. Gjatë vizitës së GVJ në Institucion, në takimin që pati me sekretarinë mësimore evidentoi se brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve, studenti ka të drejtë të shohë provimin e korrigjuar apo të bëjë ankimim në rast se ka pretendime për rezultat më të lartë. .		
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Pas shpalljes së rezultateve studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve (48 orëve). Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit dhe në dorëzimin e tij në sekretarinë mësimore.		
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimeve ose nuk është dakort me vlerësimin e bërë. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani, i cili ngre një komision <i>ad hoc</i> , në përbërje të të cilit janë edhe pedagogët e komisionit të provimit. Rezultati përfundimtar pas rivlerësimit I bëhet me dije studentit nga sekretaria mësimore, brenda një jave nga depozitimi i ankesës. Ky vendim I bashkëngjitet procesverbalit të provimit. Kjo është një procedurë por që për këtë program studimi, GVJ ju bë me dije se nuk ka patur raste ankimimi për provimet.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>






**Standardi III.7**

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Kurrikula e programit të studimit përmban module dhe lëndë nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit bankar dhe financiar si edhe vendimmarrjes së biznesit ( <i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit te studimit</i> ).
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Modulet janë të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse, sipas ligjit. Nuk përfshihen lëndë në gjuhë të huaj.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në syllabuset e çdo lënde studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulën përkatës. Këtu ato njihen me temat, kohëzgjatjen e kursit, frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, si dhe literaturën bazë dhe plotësuese. Syllabusi përmban edhe numrin e krediteve të lëndës ( <i>Referenca E.2.2-Syllabuse</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Në fund të semestrit, pedagogët e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synoheshin të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Studentët orientohen në lidhje me çështjet më të rëndësishme ku do të përqëndrohet përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë ky provim.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në këtë program studimi organizohen leksione të hapura nga personeli akademik dhe lektorë të ftuar për tema të veçanta dhe që janë me interes për studentët ( <i>Referenca E.3.4-Leksione te Hapura</i> ).
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që ti pajisin studentet me aftësi për tju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurrikula e programit të studimit dhe plani mësimor, i lë në semestrin e dytë hapësirë angazhimit të tyre në praktikën profesionale. Kjo ju jep mundësinë studentëve për ti zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në	Syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit u japin mundësinë studentëve të realizojnë detyra e kursit (apo projektet



grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	e kursit), në lëndët/modulet ku ajo është pjesë e planit mësimor. Ato synojnë që të krijojë tek studentët mundësinë për të analizuar një rast real me të dhëna të ofruara nga pedagogu apo dhe të dhëna të cilat mund të sigurohen nga vetë studentët, sipas udhëzimeve të pedagogut ( <i>Referenca E.2.2-Syllabuse</i> ).						
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Nga vizita dhe takimi me studentët, konstatoam se personeli akademik krijon një klimë të përshtatshme për mbështetjen e studentëve dhe angazhimin e tyre në studime e në punë kërkimore-shkencore. Angazhimi i studentëve në kryerjen e detyrave të kursit, si një detyrim i programit i ka mundësuar atyre që të kryejnë vetë studime më të thelluara kërkimore e shkencore. Universiteti Privat “Albanian University” organizon Konferenca Studentore, ku studentët kanë marrë pjesë me punime shkencore të tyre, rezultat i mbështetjes së vazhdueshme që i jep personeli akademik.  <i>Referenca E.1.8- Konferenca studentore</i> <i>Referenca E.2.11-Postera Konferenca</i>						
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Shpenzimet e pjesmarrjes dhe të botimit të temave të Konferencës studentore sponsorizohen nga Institucioni. Gjithashtu, në Universiteti Privat “Albanian University” organizohen edhe konkurse për projekte dhe ide inovative, dhe realizohen me mbështetje këshilluese nga stafi akademik.						
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Për rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe për tu dhënë atyre aftësi praktike, personeli akademik i departamentit, në vazhdimësi ka ndërthurur format e mësimdhënies me vizita në institucione të tjera brenda vendit më të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. Nga takimi në institucion na u komunikua që nuk ka pasur raste të studentëve master të këtij programi studimi, për mobilitetin në kuadër të marrëveshjeve që ka Institucioni.						
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

### Standardi III.8

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit,	Universiteti Privat “Albanian University” ka realizuar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike kryesisht

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

40



të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	dhe private, të cilat shfrytëzohen edhe për praktikën profesionale të studentëve të programeve master ( <i>Referenca Tabela 5</i> ). Është konstatuar se institucioni mund të akomodojë të gjitha kërkesat e studentëve për praktika, nëse kërkohet nga studentët dhe nëse studentët nuk kanë mundësinë ejetjes vetë të subjektit ku mund të zhvillojë praktikën profesionale (kur është i papunë ose kërkon një subject tjetër të ndryshëm nga ku ai mund të jetë i punësuar)		
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Praktika profesionale përfundon me një raport mbi eksperiencën e fituar. Mbrojtja e saj me sukses shoqërohet me fitimin e 6 krediteve ECTS ( <i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit të studimit</i> ).		
<b>Kriteri 3.</b> Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi III.9

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Nga verifikimi i GVJ diplomimi studentëve në këtë program bëhet me mbrojtjen e një punimi diplome. Kriteret dhe procedurat e diplomimit përcaktohen në <i>Rregulloren e Programit të studimit (Neni 30, 31)</i> si edhe në rregulloren e punimit të temës së diplomës ( <i>Referenca E.3.11-Rregullore e punimit të Temës së Diplomes</i> ).  <i>Sugjerohet që punimet e diplomave master të publikohen në faqen e internetit të Universitetit Privat "Albanian University".</i>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Strukture përgjegjëse e këtij programi është Departamenti i Shkencave Ekonomike, i cili sipas rregullores dhe atyre që konstatuam i bën të ditur studentëve kriteret e diplomimit. Për këtë angazhohej stafi akademik. Sipas kriterëve studenti depoziton kërkesën pranë departamentit për tu listuar në listën e studentëve për mbrojtje diplome ( <i>Referenca E.5.1-Listë e Temave të Diplomave</i> ). Në kërkesë ai parashtron temën e diplomës brenda fushës së studimit dhe propozon pedagogun udhëheqës. Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat e studentëve, mbi bazën e të cilave harton listën e studentëve që plotësojnë kriteret për të përgatitur një punim diplome dhe



	<p>udhëheqësin dhe ja paraqet për miratim Dekanit të Fakultetit. Drejtuesit e temave të diplomës për të gjithë studentët e listuar që plotësojnë kriteret, miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Formati i paraqitjes së punimit të diplomës është përcaktuar edhe në rregulloren e punimit të diplomës. (Referenca E.3.11-Rregullore e Punimit te Temes se Diplomes).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Cikli i dytë i studimeve Master Profesional përmbillet vetëm me mbrojtjen e mikrotezës. Mbrojtja e mikrotezës bëhet para një komisioni prej 3 ose 5 anëtarë të stafit akademik që japin mësim në këtë program studimi, të propozuar nga njësia bazë dhe të miratuar nga njësia kryesore.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Sipas vizitës në institucion, Universiteti Privat “Albanian University” stafi akademik ofron mundësinë për të udhëzuar studentët në lidhje me punimin e diplomës. Në dokumentacionin e paraqitur nga insticioni përshkruhen me hollësi procedurat si dhe udhëzimet për punimin e diplomës.</p> <p><i>Nga takimi që GVJ pati me studentët e këtij programi studime, u evidentua se studentet nuk ishin të gjithë të qartë dhe nuk e kishin filluar në kohë ose ende punën përgatitore për punimin e diplomave.</i></p> <p><i>Reference E.3.11-Rregullore e punimit te Temes se Diplomes.</i> <i>Reference E.5.1-Liste e Temave te Diplomave</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>GVJ vlerësoi nga takimet se studentët e programit të studimit, e përdorin shumë pak bibliotekën e institucionit, kjo për shkak të mos përputhshmërisë së orarit zyrtar të bibliotekës dhe orarit të mësimit për këtë program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Nga verifikimet dhe vizita në institucion u konstatua se pedagogu udhëheqës i temës përgatit metodikën e studimit për realizimin e temës së diplomës dhe mbi bazën e saj organizohet e gjithë puna kërkimore që duhet të kryejë studenti, duke i dhënë atij të gjithë asistencën e nevojshme për realizimin e punimit të diplomës nga fillimi i kërkimit deri në shkrimin e raportit të punimit, duke garantuar në këtë mënyrë cilësinë e tij. Gjithashtu, udhëheqësi në përfundim të punimit harton një raport të shkurtër me anë të të cilit e miraton atë, ose në rastet kur studentin nuk i është përmbajtur kriterëve dhe udhëzimeve të tij nuk e miraton, ose i ben vërejtjet për përmirësim (Referenca E.3.11-Rregullore e punimit te Temes se Diplomes).</p>



<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studentët vlerësohen me notë për mbrojtjen e diplomës dhe kjo pasqyrohej në procesverbalet e depozituara në sekretarinë mësimore.			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Siç është e parashikuar në nenin 55 të rregullores së Universitetit Privat “Albanian University”, në përfundim të studimeve në Programin Master Profesional, studenti pajiset me diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës.  <i>Referenca E.1.3-Rregullore e Pergjithshme e AU</i> <i>Referenca Extra 1-Diploma</i> <i>Referenca Extra 2-Suplementi</i> <i>Referenca Extra 3-Lista e Notave</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studentit, me kërkesë të tij, i vihet në dispozicion kopje e plote zyrtare e programit të studimit.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Dokumentacioni për studentët ruhet për një kohë të pacaktuar nga institucioni si në hard-copy edhe në databazën digjitale që disponon Universiteti Privat “Albanian University”.  GVJ konstatoi që dokumentacioni për studentët në vite është i plotë.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e	Universiteti privat “Albanian University” ka në organigramën e tij zyrën e Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të stafit akademik dhe administrativ të Universitetit. Bazuar në

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)





43





<p>personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe njëkohësisht në intervistat e zhvilluara me personelin e zyrës së burimeve njerëzore në ambjentet e universitetit, kjo zyrë është përgjegjëse për mbledhjen dhe ruajtjen e dokumentacionit procedural që nevojitet për stafin akademik efektiv. Gjithashtu kjo zyrë është përgjegjëse për mbledhjen dhe ruajtjen e dokumentacionit të nevojshëm për stafin që angazhohet me kontrata. Përgjegjësi e zyrës së burimeve njerëzore është dhe përditësimi i të dhënave të stafit për çdo vit akademik. Ndjekja e procedurave për rekrutimin e personelit është një tjetër përgjegjësi e kësaj zyre. Kriteret për rekrutimin i përcaktonte Departamenti përkatës, dhe zyra e burimeve njerëzore priste aplikimet të cilat kontrolloheshin nga personeli përgjegjës, dhe më pas procedoheshin për intervistim. Zyra e personelit ishte pjesë e të gjitha hallkave të procesit duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale. GVJ përzgjodhi dy dosje të rastësishme për investigim (PAE/PAK) dhe nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion.</p> <p><i>Referenca E.4.1.a-Kontrata PAE</i> <i>Referenca E.4.1.b-Kontrata PAK</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University” në përputhje me <i>nenin 33 dhe 38</i> të statutit ka të përcaktuar procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Këto procedura janë të reflektuara në Rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloren e Fakultetit.</p> <p>Njësia bazë e cila bën planifikimin për staf akademik është departamenti. Planifikimi për staf bazohet në numrin e studentëve të planifikuar për vitin akademik. Ky planifikim për rekrutimin e stafit miratohet nga Fakulteti e më pas publikohen në faqen e internetit të institucionit. Cdo kandidaturë për pozicionet e hapura vlerësohet nga një Komision, i cili përbëhet nga përfaqësues të fakultetit si edhe të departamentit.</p> <p><i>Referenca E.1.5- Statuti i Albanian University</i> <i>Referenca E.4.2- Rregullore FSHAE</i> <i>Referenca E.4.3- Procedure Rekrutimi</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Departamenti është njësia e cila përcakton kriteret specifike dhe të përgjithshme për vlerësimin e kandidatëve për personel akademik. Kriteret e vendosura janë konfront akteve rregullatore dhe nevojave të universitetit dhe njësive bazë të tij për staf akademik. Pozicionet së bashku me kriteret e kërkuara bëhen publike në faqen e institucionit.</p>




<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore disponon të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me procedurat e rekrutimit të personelit. GVJ përzgjodhi dy dosje rastësore të cilat ishin të paisura me dokumentacionin e plotë të tillë si: CV, diploma, lista e notave të noterizuara të programeve të ndjekura, kontrata e punës etj. Nga dokumentacioni i dosjeve kishte përputhje të kritereve të shpallura dhe dokumentave të cilat GVJ identifikoi në dosje.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Universiteti Privat “Albania University” ka të pajisura zyrat e personelit akademik me infrastrukturën e duhur për zhvillimin e procesit akademik dhe kërkimor. Gjatë vizitës së kryer në ambjentet e universitetit, evidentuam se infrastruktura ka krijuar mjedisin dhe kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për personelin, në mënyrë që ato të kryejnë detyrat akademike dhe kërkimore në mënyrë profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë intervistave në institucion me stafin akademik identifikuam që Universiteti për kualifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të stafit përdor kryesisht mobilitetet. Gjithashtu duhet të theksojmë që nga intervistat e zhvilluara me stafin ato konfirmun se organizohen edhe trajnime specifike për zhvillimin e tyre. (Referenca E.3.5 -Agjenda e Trajnimeve te personelit akademik-19-20)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>GVJ nuk evidentoi organizimin e programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies, por identifikoi nga intervistat e kryera me stafin zhvillimin e trajnimeve në lidhje me çështjet e mësimdhënies inovative. Trajnimet e stafit janë kryer nga trajnues vendas dhe të huaj me fokusin specifik të zhvillimit profesional dhe të ndërkombëtarizimit të institucioneve të arsimit të lartë. (Referenca E3.5 -Agjenda e Trajnimeve te personelit akademik-19-20)</p>





<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion universiteti privat 'Albania University' ka angazhuar staf akademik kryesisht të jashtëm për të plotësuar kërkesat e programit, përkatësisht 21 PAK kundrejt 13 PAE. <i>Kriteri 70% e personelit të jetë staf i brendshëm nuk plotësohet.</i> Mospërmbushja e këtij kriteri u konfirmua edhe nga shefja e Departamentit.</p> <p>Nga evidencat e dorëzuara nga Institucioni, stafi angazhohet në të gjithë programet e Fakultetit, pra nuk është i kufizuar vetëm në një program studimi, duke pasur në këtë mënyrë një angazhim optimal.</p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>GVJ bazuar në vizitën në institucion, RVB dhe të dhënave të sistemit AMS për infrastrukturën e universitetit konstaton se institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare me hapësira të mëdha dhe të bollshme dhe salla konferencash të paisura me infrastrukturën e nevojshme teknologjike. Sallat e leksioneve dhe auditorët janë të paisura me kompjutera dhe videoprojektor. Njëkohësisht, konstatuam se dhe zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si: Biblioteka, Burimet Njerëzore, Sekretaria mësimore, Financa, etj janë të akomoduar në ambjentet e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktiviteteve të tyre. Në dispozicion të studentëve dhe stafit në universitet janë akomoduar dhe ambiente shlodhëse si bar/kafe.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ bazuar në vizitën në institucion dhe në RVB, konstatoi, që ambjentet janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Ambjentet përfshijnë salla leksionesh dhe auditorë, salla konferencash, zyra dhe laboratorë. Të gjitha klasat mësimore janë të pajisura me mjete e nevojshme audio-vizive të tilla si kompjutera personal (PC), video projektorë e sisteme fonie, si dhe sisteme ndihmëse për zhvillimin e mësimin në kushte komode të tilla si internet wireless, sisteme kondicionimi etj.</p>



	<i>(Referenca Tabela 6)</i>		
	Godina e Universitetit Privat "Albanian University" ku zhvillohet mësimi edhe për këtë program studimi, plotëson të gjitha kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre", sipas të cilit kërkohen 2.5 m <sup>2</sup> / student.		
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Universiteti privat 'Albania University' në strukturat e tij ka laboratorë, por në këtë program studimi nuk zhvillohen orë të laboratorike. Sipas universitetit mungesa e orëve laboratorike janë për shkak të tipologjisë së lëndëve që zhvillohen.		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ëve të studimit që ofron.	Institucioni brenda njësisë së tij ka ngritur laboratorin e Informatikës i cili ka një kapacitet prej 30 kompjuterash, të cilët janë të pajisura me programe që ndihmojnë studentët. për realizimin e detyrave të ndryshme. Laboratori është në dispozicion të të gjitha programeve të studimit, dhe asistohet dhe nga staf i dedikuar i IT.		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zivillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Institucioni është në gjendje të garantojë kapacitete infrastrukturore për të kryer veprimtaritë praktike lidhur me programin. Gjithashtu institucioni ka marrëveshje me institucione të tjera në lidhje me praktikën, kjo e bazuar në dokumentacionin e paraqitur.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	GVJ bazuar në RVB dhe gjithashtu në vizitën e kryer në institucion konstatoi që Universiteti privat "Albania University" ka një bibliotekë të vendosur në godinën kryesore ku zhvillohet dhe mësimi për këtë program studimi. Në bibliotekë ekziston

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



	<p>mundësia e barabartë për të gjithë studentët e këtij programi studimi për të shfrytëzuar literaturën e bibliotekës, si dhe për të shfrytëzuar ambjentet e saj për studim.</p> <p><i>GVJ ka theksuar dhe më parë në këtë raport që biblioteka nuk shfrytëzohet nga studentët e këtij programi, pasi ka një mospërputhje ndërmjet orarit të studimit dhe orarit zyrtar të bibliotekës.</i></p>						
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka ishte e paisur me literaturë në gjuhën shqip dhe anglisht. Në bazë të RVB dhe vizitës në ambjentet e universitetit GVJ identifikoi se pjesa më e madhe e literaturës ishte në gjuhën shqipe në formë 'hard copy' dhe në formë elektronike. Ambjentet e bibliotekës ishin të pajisura me kompjutera dhe akses në internet, dhe studentët mund ti aksesonin këto ambjente për të zhvilluar punët e tyre akademike. Biblioteka pasurohet dhe me punime, materiale didaktike dhe libra që depozitohen në bibliotekë.</p> <p>(Referenca E.3.6-Lista e Librave).</p>						
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti privat 'Albania University' ka krijuar akses të vecantë në biblioteka online të tilla si: ERIC-Education Resources Information Center, Cambridge Journal, EBSCO.</p> <p>(Referenca Tabela 17)</p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e paisur me kompjutera të cilat mundësojnë aksesimin në bibliotekat online për të gjithë studentët e universitetit. Biblioteka ka akses pa limit në EBSCO për të gjithë dhe në të gjitha paisjet kompjuterike që ajo ka.</p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Për cdo vit akademik institucioni shton zërat e bibliotekës, bazuar në kërkesat e njësisive bazë. Departamentet kërkojnë cdo vit shtim titujsh të ri në bibliotekë apo dhe kopjosh të titujve ekzistues.</p> <p>(Referenca E.3.7-Procedure blerje libra).</p>						
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Edhe pse në RVBdeklarohet se ky kriter plotësohet, <i>GVJ gjatë takimit që pati në institucion me studentët, evidentoi se ky kriter nuk plotësohet, pasi orari i bibliotekës dhe orari i mësimit për studentët e këtij programi studimi nuk përputhet.</i> Orari i deklaruar i bibliotekës është nga ora 8.00 – 16.00 nga dita e hënë në të premte, ndërsa ditën e shtunë punon me orar të reduktuar e përkatësisht nga ora 8.00 deri në orën 12.00. Orari i mësimit të këtij programi studimi është ndërkohë nga ora 17.00 deri në orën 20.00 nga dita e hënë deri në ditën e premte.</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						



**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sekretaria mësimore, e cila është përgjegjëse për administrimin e informacionit për studentët, disponon një sistem manaxhimi online për studentët. Ky sistem pajis me llogari personale cdo student, të cilët pas logimit në sistem me anë të kredencialeve të tyre mund të marrin cdo informacion që i nevojitet. Dokumentacioni themelor për studentët është: regjistri themeltar, që vërteton regjistrimin e studentit pajiset me numër matrikullimi, regjistri i arritjeve akademike të studentëve si dhe regjistri i lëshimit të diplomave. Këto regjistra pas diplomimit të studentëve arkivohen në arkivën e shtetit shqiptar dhe të Universitetit Privat “Albanian University”-së në formë hardcopy dhe elektronike. Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit.</p> <p><i>Referenca E.3.12-Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Zyra përgjegjëse për administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ është zyra e burimeve njerëzore. GVJ pas takimit me stafin e zyrës së burimeve njerëzore identifikoi se zyra administrojnë dhe ruan informacionin për stafin. Ky informacion ruhet kryesisht në formë manuale, por dhe elektronike kryesisht në njësitë bazë si departamente.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Monitorimi i aktiviteteve në Departamentin e Shkencave Ekonomike, si për stafin akademik dhe për stafin administrativ bëhet nga përgjegjësi i departamentit. Të gjitha raportet që gjenerohen nga departamenti në lidhje me ngarkesat mësimore, oraret etj dërgohen në fakultet. Sistemi i menaxhimit të studentëve sipas RVB i jep mundësinë cdo studenti qoftë në mënyrën online qoftë nëpërmjet sekretarisë mësimore të gjenerojnë informacionin e kërkuar.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Komunikimi ndërmjet stafit akademik dhe ndihmës akademik me studentët kryhet nëpërmjet adresave zyrtare të universitetit. Në fillim të ciklit të parë të studimeve cdo student pajiset me një email zyrtar të universitetit, dhe mund ta përdorë atë si formë zyrtare komunikimi me stafin akademik dhe ndihmës akademik deri në përfundimin e studimeve të tij.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale</p>	<p>Aktivitetet akademike dhe administrative publikohen në kohë reale në faqen e webit të Universitetit. Raportimet individuale</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

49





dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	për titullarët dhe drejtuesit bëhen me anë të adresave zyrtare të emailit.		
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	<p>GVJ konstatoi që faqja e internetit të institucionit (<a href="http://www.albaniauniversity.edu.al">www.albaniauniversity.edu.al</a>) përfshin një informacion të gjërë ku ndër të tjera: informacionin lidhur me programin dhe stafin sikurse dhe njoftime të ndryshme.</p> <p>Faqja web është e ndërtuar në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.</p> <p>Një mjet tjetër komunikimi i përdorur janë dhe rrjetet sociale ku universiteti privat 'Albania University' është aktiv në komunikimet e tij.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ bazuar në RVB dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatoi se institucioni Universiteti privat 'Albania University', harton raportin financiar dhe buxhetin konfort standarteve kombëtare të hartimit të raporteve financiare dhe konfort ligjit të arsimit të lartë. Institucioni harton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm në bazë të nevojave. Bazuar në kriteret e vendosura nga bordi i administrimit, administratori i përgjithshëm në bashkëpunim me drejtorinë e financës dhe drejtuesit e njësive kryesore hartojnë buxhetin vjetor përpara nisjes së vitit financiar, në bazë të nevojave. Ky raport kalohet më pas në Rektorat për diskutim, më pas miratohet paraprakisht nga Senatin Akademik dhe si hallkë e fundit i kalohet për miratim Bordit të Administrimit.
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një progra studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin literaturës e aksesin në bibliotekat on-line detyrimet financiare, grantet vendëse apo huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të	GVJ bazuar në të njëjtat evidenca identifikoi ndarjen e planit financiar dhe të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në planin financiar të universitetit privat "Albania University" të ardhurat gjenerohen kryesisht nga tarifat e regjistrimit, tarifa e shkollimit, shërbime të tjera dhe burime të tjera financimi, ku vlen të theksohet që pjesa më e madhe e të ardhurave vjen si rezultat i dy zërave të parë. Ndërkohë që në planin financiar në pjesën e shpenzimeve zënë vend zëra si shpenzimet e pagave, shpenzimet operative, shpenzimet e pasurimit të literaturës,

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

50



realizimit të programit të studimit dhe zëri të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	aksesit në bibliotekën online etj, por vlen të theksohet se në rastin e shpenzimeve pjesën më të madhe zihen nga zëri i parë. GVJ identifikoi se në planin financiar zërat e shpenzimeve dhe të ardhurave ishin të përfshira sipas rregulloreve në fuqi.		
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Në universitetin privat 'Albania University' funksionon si njësi administrative zyra e auditit të brendshëm. Kjo zyrë kryen auditin e brendshëm të përvitshëm, sikurse dhe është përgjegjëse për raportet e auditimit që referohen në situatën financiare të njësisë. Raportet e përgatitura nga auditimi i brendshëm përmbajnë të gjithë informacionin financiar, të ardhurat, shpenzimet dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve financiare. Raportet e zyrës së auditit të brendshëm raportohen në mënyrë periodike pranë Bordit të Administrimit.		
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Institucioni ka të ruajtura raportet financiare të tre viteve të fundit, dokumentacion që e depoziton në arkiva cdo fund viti fiskal. Referuar RVB-së konstatohet se në mënyrë periodike Zyra e Financës dhe Auditit të Brendshëm pranë 'Albania University', hartojnë relacionin mbi projekt buxhetin me qëllim që të kontrollojnë mbarëvajtjen e të gjitha programeve të studimit të të gjitha cikleve përgjatë kohës së shtrirjes së studimeve.		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	Në dokumentacionin e vënë në dispozicion për GVJ, ky grup identifikoi qëndrueshmërinë financiare të institucionit përgjatë tre viteve të fundit bazuar në pasqyrat financiare të depozituara dhe në QKB. GVJ përgjatë vizitës së tij identifikoi se përveç raporteve financiare, nuk u verejt ndonjë dokumentacion që tregon ecurinë në vazhdim të programit lidhur me financimin e tij.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Të gjitha rregulloret e universitetit privat ‘Albania University’ të tilla si: rregullorja e institucionit, rregullorja e fakultetit të shkencave të aplikuara dhe ekonomike, rregullorja e Departamentit dhe këtij programi studimi janë të hartuara bazuar në ligjin në fuqi për arsimin e lartë. Të gjitha rregulloret sikurse edhe Rregullorja për regjistrimin dhe transferimet në AU, specifikojnë politikat dhe procedurat që ndjek institucioni për pranimin, transferimin apo largimin e studentëve nga programi i studimit.</p> <p><i>Referenca E.1.3-Rregullore e Pergjithshme e AU</i></p> <p><i>Referenca E.4.2- Rregullore FSHAE</i></p> <p><i>Referenca E.2.2-Rregullore DSHE</i></p> <p><i>Referenca E.2.5-Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB dhe në intervistat me studentët e këtij programi studimi, identifikoi se politikat dhe procedurat që në momentin e fillimit të këtij cikli studimi e deri në përfundim të tij garantojnë barazi dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student, sikurse dhe për studentët e programit. Po të njëjtat barazi dhe të drejta të barabarta ndiqen përgjatë të gjithë ciklit të studimit. Procedurat e ndjekura e të identifikuar dhe përgjatë intervistës me studentët janë pjesë e rregullores së Fakultetit të Shkencave të aplikuara dhe Ekonomike, dhe gjithashtu gjenden dhe në faqen zyrtare të ëeb të universitetit privat ‘Albania University’.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në rregulloret e Universitetit Privat ‘Albanian University’, të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, të Departamentit të Shkencave Ekonomike dhe të programit të studimit. Në këtë program studimi ka patur edhe transferime studentësh (Tabela 21).</p>




	<p>Të gjitha politikat dhe procedurat postohen dhe bëhen publike përmes faqes së internetit të universitetit privat 'Albania University' dhe në ditët e karrierës që zhvillohen në ambjentet e Universitetit privat 'Albania University'.</p> <p>Ky institucion në fillim të çdo viti akademik, organizon javën orientuese, gjatë së cilës informon studentët e programit të studimit për gjithçka lidhur me periudhën e studimeve. (Referenca E.5.2-Agjenda e Javes Orientuese.)</p> <p><i>Bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion, por dhe nga vizita me studentët e këtij programi studimi, GVJ evidentoi se kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi nuk janë shumë rigorozë, pranimet në këtë program janë të hapura. Ky program lejon hyrjen edhe të studentëve që vijnë nga shkencat sociale, që nuk kanë formim paraprak në shkencat ekonomike dhe kjo e vështirëson përvetësimin e programit, ose pengon progresin e pjesës tjetër të studentëve të ndjekin rregullisht leksionet dhe seminarat.</i></p> <p><i>GVJ sygjeron se ndoshta për këtë kategori studentësh duhen parashikuar cikël leksionesh parapërgatitore dhe integruese para se të fillojë procesi i leksioneve dhe mësimi të rregullt.</i></p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB dhe vizitës në universitet identifikoi që kriteret për pranimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve, miratohen në fillim të vitit akademik konfort të gjitha rregullave dhe ligjeve në fuqi.</p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>Universiteti privat 'Albania University' informon të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit. GVJ sipas informacioneve të mbledhura në këtë institucion konstatoi që kjo bëhet nëpërmjet informimit dhe vizitave në gjimnaze sikurse dhe nëpërmjet ditëve të karrierës.</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="603 1384 762 1444">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="762 1384 976 1444">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="976 1384 1394 1444">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="603 1444 762 1496"></td> <td data-bbox="762 1444 976 1496" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="976 1444 1394 1496"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion informacionin e plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjëndet në rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, në</p>





<p>studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>rregulloren e Departamentit të Shkencave Ekonomike sikurse dhe në rregulloren e programit të studimit. Informacioni i vihet në dispozicion studentëve edhe nëpërmjet takimeve të studentëve me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët. (Referenca E.5.3.a-Rregullore e ZKMS).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme.</p>	<p>Zyra e transferimeve dhe ekuivalentimeve të studimeve bë bashkëpunim me departamentin njih studentët me kriteret dhe procedurat përkatëse të transferimit të studimeve. Këto procedura janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit, të fakultetit dhe të programit të studimit, dhe i bëhen me dije studentëve të cilët duan të transferojnë studimet e tyre si brenda dhe jashtë vendit, sikurse dhe studentëve të cilët duan të transferohen në këtë institucion. Njohja e krediteve të fituara nga studimet e mëparshme bëhet nga Komisioni ad-hock i Ekuivalentimit.</p> <p><i>Referenca E.1.3-Rregullore e Pergjithshme e AU</i></p> <p><i>Referenca E.1.6-Rregullore e programit te studimit.</i></p> <p><i>Referenca E.2.5-Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni njih studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Këto kriteret dhe procedura janë të përcaktuara në rregulloret e njësive kryesore dhe bazë sikurse dhe në syllabuset e të gjitha lëndëve të këtij programi studimi. Institucioni përmes pedagogëve të secilës lëndë, bën me dije mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve që në orën e parë të vitit akademik. GVJ përmes vizitës në institucion dhe komunikimit me studentët identifikoi tranferimin e këtij informacionit në kohën e duhur tek studentët.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e punimit të temës së diplomës janë të përcaktuara në rregulloren e Fakultetit të shkencave të aplikuara dhe Ekonomike, sikurse dhe në rregulloren e departamentit. Gjithashtu institucioni ka hartuar një udhëzues për punimin e temës së diplomës, i cili u bëhet me dije studentëve në takimet e tyre në departament nga shefi i departamentit, pedagogë dhe nga pedagogu udhëheqës i temës së diplomës.</p> <p><i>Refrenca E.3.11-Rregullore e punimit te Temes se Diplomes</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Përpara fillimit të cdo viti akademik institucioni organizon takime të hapura për informimin e studentëve potencial për programin e studimit. Këto takime informuese bëhen si në shkollat e mesme ashtu dhe në ditët e karrierës në ambjentet e universitetit. Gjithashtu universiteti është aktiv në rrjetet sociale dhe në faqen e tij të webit duke mundësuar dhe me anë të kësaj</p>



	mënyre komunikimi ndarjen e informacionit mbi programin e studimit.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit nëpërmjet shumë formave të komunikimit që universiteti privat 'Albania University' ofron. Institucioni përcjell këtë informacion nëpërmjet fletëpalosjeve, komunikimit me sekretarinë apo dhe takimet e hapura që zhvillohen në ambjentet e universitetit. Një mënyrë tjetër që institucioni përdor për përcjelljen e këtij informacioni është edhe faqja zyrtare e internetit ku publikohen të gjitha informacionet në mënyrë të hollësishme. Struktura e programit dhe lëndët e tij shfaqen gjithashtu dhe në stendat e universitetit.  <i>Referenca E.5.2-Agjenda e Javes Orientuese</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe komunikimit me studentët evidentoi që informacioni dhe dokumentacioni për lëndët, përmbajtjen dhe veprimtarinë formuese i vihet në dispozicion atyre që në ditën e parë të fillimit të vitit akademik. Gjithashtu në ditën e parë të mësimit cdo pedagog bën prezantimin e lëndës, sylabusit dhe mënyrës së vlerësimit. Sipas verifikimeve të GVJ i gjithë informacioni në lidhje me lëndët e këtij programi studimi gjëndet dhe në faqen web të këtij institucioni.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Zyra e Kordinimit dhe Mbështetjes për Studentët sikurse edhe Zyra e Karrierrës dhe Alumnit janë zyrat përgjegjëse për informimin e studentëve në lidhje me punësimin dhe orientimin drejt tregut të punës. Gjithashtu universiteti zhvillon nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani të ndryshme, i ofron studentëve mundësi për praktika pune. Universiteti ka ruajtur kontaktet me të diplomuarit e saj, duke krijuar rrjetin Alumni, rrjet i cili forcon bashkëpunimet me kompani të ndryshme të cilat i ofrojnë mundësi punësimi studentëve të këtij institucioni.





	<i>Referenca E.5.3.a-Rregullore e ZKMS</i>		
	<i>Referenca E.5.3 -Rregullore e ZKA</i> <i>Referenca Tabela përmbledhëse, tabela 5</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Institucioni nëpërmjet rrugëve të saj të komunikimit i ofron studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me procesin mësimor, infrastrukturën dhe shërbimet në dispozicion. Plani dhe orari mësimor afishohen në ambjentet e fakultetit, dhe studentët në javën e parë të mësimin, informohen mbi logjistikën dhe infrastrukturën e universitetit lidhur me mjediset që do përdoren nga ata gjatë studimeve, si klasat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, laboratorët etj. Studentët e këtij programi e ndjekin mësimin mbasdite ora 17.00-20.00, një mundësi kjo për të ndihmuar studentët e punësuar, sikurse dhe një mundësi për studentët që do të duan të fillojnë punë përgjatë studimit.</p> <p>Në Sekretarinë Online dhe faqen web hidhen gjithë të dhënat e nevojshme mbi orarin, aktivitete kurrikulare dhe ekstra kurrikulare, si dhe cdo informacion tjetër që lidhet me mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p><i>Referenca E.5.2-Agjenda e Javes Orientuese</i></p>		
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	<p>GVJ gjatë intervistës me stafin akademik por edhe grupin e punës na u referua se secili pedagog ofron komunikimin me e-mail me studentët. Aksesimi i emaileve si nga ana e studentëve ashtu dhe nga ana e pedagogëve bëhet nëpërmjet pajisjeve të tyre elektronike, ose nga kompjuterat e vënë në dispozicion në laboratorët e teknologjisë.</p> <p>Gjithashtu ky institucion ka shpenzuar dhe shpenzon effort për komunikimin nëpërmjet webit dhe rrjeteve sociale, ku përditëson dhe ndan informacionin i cili është i plotë dhe i aksesueshëm në cdo kohë.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

#### **Standardi V.4**



**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë\*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore identifikoi që kjo sekretaria mban statistikat në lidhje me numrin e studentëve të diplomuar për këtë program studimi.</p> <p><i>Referenca E.3.12-Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon të gjitha statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet dhe largimet përpara përfundimit të vitit akademik, informacione të regjistruara në regjistrat e sekretarisë mësimore. GVJ identifikoi që në këto regjistra për tre vite bazuar në vizitën në institucion sikurse dhe dokumentit (<i>Tabela përmbledhëse, tabela 21</i>), numri i studentëve në këtë program studimi është:</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019 janë të regjistruar 18 studentë</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020 janë të regjistruar në total 26 studentë</p> <p>Në vitin akademik 2020-2021 janë në total 14 studentë</p> <p>Vihet re se ka një ulje të numrit të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Sekretaria mësimore regjistron informacionin për ecurinë e studentëve (vlerësimin me notë) përgjatë gjithë kohës së studimit deri në përfundim të tij. GVJ gjatë vizitës në institucion përzgjedhi dosje të rastësishme të studentëve sikurse dhe pa regjistrat themeltar. Në rastin e regjistrave themeltar u evidentua paisja e studentëve me numër matrikullimi. Në doset e studentëve GVJ vërtetoi rregullsinë e dosjeve me dokumentat e noterizuara të studentëve të përfshira në të. Dosja e studentëve ishte e pajisur me dokumentat si vijon: kontrata, deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, diploma e shkollës së mesme, diploma e studimeve të ciklit të parë dhe lista e notave.</p> <p><i>(Referenca E.3.12-Rregullore e sekretarisë mësimore)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për ruajtjen, manaxhimin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me studentët. GVJ gjatë vizitës në institucion identifikoi lehtësinë e aksesimit të informacionit nga personat e autorizuar dhe përgjegjës për të. Të gjitha detyrat dhe rregullat e procedimit të sekretarisë mësimore janë të përcaktuara në rregulloren e kësaj sekretarie.</p> <p><i>Referenca E.3.12-Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Në universitetin privat ‘Albania University’ disponohen të dhëna të plota në lidhje me mesataret e studentëve në hyrje dhe në përfundimin e programit të studimit. Gjithashtu institucioni ka të dhënat e punësimit të studentëve pas përfundimit të ciklit të studimit. GVJ evidentoi që ky institucion kryen analiza mbi</p>



	profilin e studentëve në hyrje dhe dalje në fund të cdo viti akademik. <i>Referenca Tabela përmbledhëse, tabela 21, 23</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>		<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi V.5

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Referuar statutit të universitetit privat 'Albania University' studentët duhet të jenë të angazhuar dhe vendimmarrës në aktivitete kërkimore dhe kulturore sikurse dhe të jenë të përfaqësuar në senatin akademik. <i>Referenca E.1.5- Statuti i Albanian University</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJG bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion sikurse dhe në vizitën në institucion, konfirmoi se studentët ishin të përfshirë në vlerësimin mbi procesin akademik (studentët ishin pjesë e GVB). Nga biseda me grupin e studentëve konstatuam qe ata këshillohen me stafin akademik dhe shefin e departamentit. Sipas Statutit ata kanë formuar edhe Këshillin studentor ( <i>neni 49 i Statutit të Albania University</i> ). Studentët kishin përfaqësuesin e tyre në zyrën e NJBSC ( <i>Tabela përmbledhëse, tabela 24</i> ).
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.	GVJ në bazë të dokumentave të vëna në dispozicion, evidentoi që institucioni merr parasysh ngarkesën akademike të studentëve në këtë program studimi, kur harton programet e studimit. Ngarkesa e studentëve e përkthyer në orë në auditor dhe jashtë auditorit llogaritet në hartimin e programit të studimit. Statuti i universitetit dhe rregulloret parashikojnë procedura joburokratike për përparimin e studentëve gjatë zhvillimit të studimeve dhe njohjen e studimeve të plota apo të pjesëshme të mëparshme.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Bazuar në statutin e universitetit përfshirja reale e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit bëhet nëpërmjet përfshirjes në organe këshilluese dhe vendimmarrëse. Rezultati i përfshirjes reale të studentëve nuk bazohet vetëm në statutin e institucionit por gjithashtu dhe në pyetsorët e plotësuar nga studentët në fund të cdo viti akademik.



	<i>(Referenca E.1.5- Statuti i Albanian University, neni 25). (Referenca E.3.1.a-Pyetesoret e studenteve)</i>		
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Rregulloret e institucionit i japin studentëve mundësinë për të dhënë mendimin mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit, sikurse dhe për ankimimin e rezultateve dhe rishikimin nga ana e pedagogëve përgjegjës. Të gjitha procedurat që ndiqen janë të përcaktuara nga institucioni nëpërmjet rregulloreve në fuqi.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>		<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi V.6

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Procedurat që ndiqen lidhur me informimin dhe shërbimin ndaj studentëve janë të përcaktuara në statutin e universitetit dhe në rregulloret e tij  Informimi i studentëve kryhet nëpërmjet zyrës për koordinimin dhe mbështetjen e studentëve sikurse dhe zyrës së karrierës.  <i>Referenca E.5.3.a-Rregullore e ZKMS Referenca E.5.3 -Rregullore e ZKA</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	GVJ bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion sikurse dhe në statutin e universitetit konstatoi mundësinë e asistimit të studentëve në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me programin mësimor dhe me programming e studimit. Të drejtat e studentëve në këtë drejtim janë të përcaktuara dhe në rregulloren e zyrës për koordinimin dhe mbështetjen e studentëve sikurse dhe të zyrës së karrierës dhe rrjetit Alumni.  <i>Referenca E.5.3.a-Rregullore e ZKMS Referenca E.5.3 -Rregullore e ZKA</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me	Referuar dokumentacionit, ( <i>Referenca E.5.3.a-Rregullore e ZKMS; Referenca E.5.3 -Rregullore e ZKA</i> ) institucioni ofron komunikim të vazhdueshën për ti shërbyer nevojave të studentëve për këshillim karriere. Ky institucion nëpërmjet konsultimeve dhe partneriteteve të qëndrueshme, ofron informimin lidhur me mundësi për pjesëmarrje në konferenca studentore, lidhur me



kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	mundësi të ndryshme studimi në të gjitha nivelet jashtë vendit, trajnime, praktika, shkolla verore si dhe realizimin e praktikave profesionale pranë insitucioneve, sipërmarrjeve dhe organizatave të ndryshme. I gjithë informacioni i shpërndarë dhe mundësitë e ofruara shërbejnë për zhvillimin e studentëve sikurse dhe për orientimin e studentëve në tregun e punës.			
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhënà mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra e Kordinimit dhe Mbështetjes për Studentët sikurse edhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit kanë si detyrë mbledhjen përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave të punësimit të studentëve pas përfundimit të programit të studimit. Zyra gjithashtu publikon mundësi punësimi për studentët e programit të studimit.  <i>Referenca E.5.3.a-Rregullore e ZKMS</i>  <i>Referenca E.5.3 -Rregullore e ZKA</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në nenin 103, të ligjit për arsimin e lartë 80/2015, është e përcaktuar se “Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë”. Universiteti Privat “Albanian University” ka ngritur struktura te tilla si NJSBC Qendrore e cila quhej “Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”, që nga 2010, dhe NJSBC pranë cdo njësie kryesore të cilat kanë hartuar procedura për të siguruar cilësinë e programeve, si dhe Grupe cilësie pranë cdo njësie bazë.



	<p><i>Referenca E.1.5- Statuti i Albanian University</i>  <i>Referenca E.1.3-Rregullore e Pergjithshme e AU</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> <p>Në nivel institucional përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Monitorimi i sigurimit të cilësisë funksionon edhe në rang fakulteti, kur kjo kërkohet nga decani ose rregulloret institucionale. Kjo njësi monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p><i>Referenca E.6.1-VS per krijimin e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i>  <i>Referencat E.6.3.a,b,c -Grupet e Cilesise</i>  <i>Referenca E.6.5.a-VR per Konsulentin Juridik</i>  <i>Referenca E.6.5.b-VR per Konsulent te zhvillimit te kurrikulave</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>AU përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. NJSBC ka një analizë në lidhje me instrumentat e sigurimit të cilësisë të përdorura gjatë vitit korent akademik, si psh raporti i vlerësimit për programin e studimit, rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e profesorëve, konkluzionet e nxjerra dhe plan aksioni per t'i vendosur në funksion.</p> <p><i>Referenca E.6.8-Rregullore e NJSBC</i>  <i>Referenca E.6.6-Formati Raporti i vleresimit per programin e studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e mbështet në rregullore. Në mënyrë periodike NJSBC-ja raporton dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e AU-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Këto raporte krahasohen me standardet e cilësisë të parashikuara në rregulloren e cilësisë dhe akte të tjera të AU-së. Zbatimi i standardeve të cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese,</p>



61





	<p>infrastrukture, etj me qëllim që të arrihen nivele maksimale në procesin mësimor dhe kërkimor.</p> <p><i>Referenca E.6.8-Rregullore e NJSBC</i>  <i>Referenca E.6.4-Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i>  <i>Referenca H.3.a,b,c-Raporti vjetor 2019-2020</i>  <i>Referenca E.6.6-Formati Raporti i vleresimit per programin e studimit</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>		<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Njësia bazë për menaxhimin e programit të studimit është Departamenti. Grupet e Sigurimit të Cilësisë të ngritura në nivel Departamenti së bashku me NJSBC e ngritur në nivel Institucional kryen mbikëqyrjen, rishikimin dhe monitorimin e programeve. Këto grupe përbëhen zakonisht nga 2-3 pedagogë me tituj e grada shkencore të cilët punojnë për rishikimin e kurrikulave dhe syllabusave. Sic përmendet edhe tek Raporti vjetor NJSBC, kjo Njësi ka si qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë përmes ushtrimit të funksioneve të saj.</p> <p><i>Referenca E.6.3 a,b,c-Grupet e Cilesise</i>  <i>Referenca E.6.1-VS per krijimin e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i>  <i>Referenca E.6.8-Rregullore e NJSBC</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Ekonomike, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara Ekonomike në AU, është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në MBA. Kjo njësi bashkëpunon me të gjitha strukturat përkatëse për garantimin e cilësisë së mësimdhënies dhe proceseve të tjera në funksion të programit të studimit. Koordinatorin e programit të studimit (<i>Referenca E.1.6 Rregullore e programit të studimit</i>) dhe drejtuesin e departamentit janë personat përgjegjës të cilët ndjekin dhe monitorojnë ecurinë e programit të studimit.</p> <p>Departamentet në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë krijojnë komisione adhoc për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p> <p><i>Referenca E.6.3.c-Grupet e Cilesise 2021-2022</i></p>



	<p><i>Referenca E.6.7-Rregullore per mbarvajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor ne AU</i></p> <p><i>Referenca E.6.6-Formati Raporti i vleresimit per programin e studimit</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>NJSBC-ja përdor metodologji dhe instrumente vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike. Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga NJSBC-ja dhe rezultatet e tyre i raporton pranë Rektoratit dhe Dekanateve të fakulteteve. Gjithashtu, departamenti përgjegjës për programin dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara Ekonomike realizojnë vlerësimin e ecurisë së mbarëvajtjes së programeve të studimit. Për realizimin e vlerësimit përdoren disa metoda si: pyetësorë me studentët, inspektime gjatë orëve të mësimit në auditor nga përgjegjës i departamentit dhe nga përfaqësues të NJSBC-së. Departamenti dhe NJSBC-ja përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme për ecurinë e treguesve të cilësisë si, treguesit për vlerësimin e programit, treguesit për vlerësimin e lëndës, treguesit për vlerësimin e procesit mësimor dhe të pedagogut, tregues për gjendjen e infrastrukturës etj.</p> <p>Metodologjitë e vlerësimit:  Anketimi i studentëve me anë të një pyetësori (<i>Referenca E.3.1.a-Pyetesoret e studenteve</i>)  Grup fokus (<i>Referenca E.3.1.b-Fokus-Grupe</i>)  Anketim për stafin akademik dhe administrative <i>Referenca E.3.1.c-Pyetesoret e personelit akademik dhe administrativ</i>  Vlerësim për ecurinë e programit të studimit (<i>Referenca E.6.6-Formati Raporti i vleresimit per programin e studimit</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Për sa i përket rezultateve të instrumentave vlerësues e monitorues, dokumentohen duke ju vënë në dispozicion drejtuesve të njësisë bazë, njësisë kryesore, Rektoratit, Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Referuar RVB, në raportet e vlerësimit përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, rezultatet e studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatarë, veprimtaria kërkimore shkencore dhe në fund ndërtohet një analizë SWOT.</p> <p>Mungon si evidence Analiza e NJSBC-së për pyetësorët e stafit akademik.</p>



	Në raportet vjetore të Departamentit dhe në raportin e NJSBC duhet të përfshihet një analizë e detajuar e matësve sasiorë dhe të adresohen mangësitë e ndryshme për përmbushje.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Departamenti i Shkencave Ekonomike i cili është përgjegjës për programin e studimit nën shqyrtim, bën vlerësime periodike të brendshme për programin e studimit dhe i pasqyron në raportin vjetor të analizës mësimore në nivel departamenti.  Gjithashtu, departamenti realizon në mënyrë periodike analizë të punës mësimore, ecurinë e programit të studimit duke evidentuar problematikat dhe masat për zgjidhjen e tyre nëpërmjet angazhimit të stafit akademik dhe personelit ndihmës në departament, por edhe në nivele të tjera më të larta në qoftë se është e nevojshme.
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Grupet e Sigurimit të Cilësisë të ngritura në nivel Departamenti së bashku me NJSBC e ngritur në nivel Institucional kryen mbikqyrjen, rishikimin dhe monitorimin e programeve.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamenti I Shkencave Ekonomike, për kryerjen e vlerësimit ka përdorur metoda të tërthorta si sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; intervista të drejtpërdrejta; grup fokuse; testime paraprake dhe përfundimtare; provime për modulet, praktikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; leksioneve të hapura etj, për mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. Në Universitetin Privat “Albanian University” përveç NJSBC, funksionojnë edhe Grupet e Sigurimit të Cilësisë të ngritura në nivel Departamenti.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të	Si pjesë e rëndësishme e filozofisë së Universitetit Privat “Albanian University” studentët inkurajohen të jenë

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

64




<p>studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>pjesëmarrës aktiv në procesin mësimor, nëpërmjet vlerësimit dhe ofrimit të mendimit të tyre pasi ata nëpërmjet përfaqësuesve janë pjesë e Senatit, Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë të Universitetit Privat “Albanian University”, këshillave studentore, Komisionit të Etikes, etj.</p> <p>Gjatë takimit që GVJ pati në institucion evidentoi se në nivel institucional por edhe në nivel njësie bazë të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, kryenin vazhdimisht sondazhe për studentët, stafin akademik dhe atë ndihmës me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.</p> <p>Sipas RVB, Departamenti i drejtohet studentëve për të marrë feedback për problematika të ndryshme që prekin drejtpër së drejti programet e studimit të ofruara. Shpesh kjo kryhet me email, takime ad-hoc ose individualisht.</p> <p>Megjithatë, Grupi i RVJ mendon se adresat e emailit të studentëve mund të mos jene gjithmonë të aksesueshme nga ana e tyre. Ndaj do të sugjeronim forma të tjera komunikimi më të shpjegta e të sigurta. Të gjitha këto pretendime duhet të mbështeten në evidence.</p>								
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përbushet pjesërisht</td> <td>Përbushet kryesisht</td> <td>Përbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<p><b>Standardi VI.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në të gjitha rregulloret si në nivel institucioni, fakulteti dhe departamenti është parashikuar angazhimi i të gjitha palëve të interesuara në realizimin e procesit mësimor cilësor. Kështu në AU, pedagogët janë jo vetëm realizuas të procesit mësimor, por edhe si një faktor i rëndësishëm përrritjen e nivelit të cilësisë duke u angazhuar në përpunimin e rregulloreve dhe standardeve të ndryshme të cilësisë. Gjithashtu, përfaqësimi i studentëve është instrument i rëndësishëm që realizohet në mënyra të ndryshme, si tërheqja e mendimit nga këshilltarët akademikë, përfaqësimin e tyre në senat dhe në organe të tjera vendimmarrëse të institucionit. Studentët janë pjesëmarrëse dhe në NJSBC, ku në rregulloren e kësaj njësie, janë parashikuar detyra konkrete për njësitë, individët, studentët, pedagogët dhe palë të tjera të angazhuara për garantimin e cilësisë së programit</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





<p>akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>të studimit. Kjo rregullore garanton përfshirjen e anëtarëve të personelit akademik dhe administrativ si dhe të studentëve. Ky funksion realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në takime dhe komisione, si p.sh. komisioni për sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet ngritjes së grupit të punës për vlerësimin e brendshëm, etj.</p> <p><i>Referenca E.1.5- Statuti i Albanian University</i>  <i>Referenca E.1.3-Rregullore e Pergjithshme e AU</i>  <i>Referenca E.6.8-Rregullore e NJSBC</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Rregullorja e insitucionit, Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Rregullorja e NJSBC, parashikojnë angazhimin e anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit në mënyrë të barabartë. Institucioni vwn zbatim edhe Kodin Etik (<i>Referenca E.6.9-Kodi i Etikës</i>)</p> <p><i>Referenca E.3.1.c-Pyetesoret e personelit akademik dhe administrative</i>  <i>Referenca E.3.1.d-Tabela per kerkimin shkencor</i>  <i>Referenca E.3.2-Raport Semestral Pedagogesh</i>  <i>Referenca E.3.3-Raport Vetevleresimi</i>  <i>Referenca E.3.9-Mbledhje Departamenti</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Universiteti Privat “Albanian University” ka realizuar takime me biznese dhe ka angazhuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

#### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen

Institucioni përmes proceseve të hapura dhe të bëra publike nw faqen web (<https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i->

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

66



publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.				
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	brendshem-i-cilesise/), fton studentët dhe personelin akademik të njihen me procedurat që institucioni kryen në kuadër të sigurimit të cilësisë së institucionit dhe programeve të studimit dhe njëkohësisht kërkon që ata të përfshihen në mekanizmat e sigurimit të cilësisë në universitet. Procesi i njohjes me procedurat apo njoftimet periodike, vijohet dhe me publikimin e rezultateve, raporteve nga procese të zhvilluara. Konkretisht, raportet vjetore, vendimet e organeve kolegjiale, raportimet periodike të Rektoratit që lidhen me procesin mësimor dhe sigurimin e cilësisë së mësimdhënies, janë proces i vazhdueshëm. Rezultatet e publikuara që dalin nga analiza të ndryshme vlerësimi të brendshëm apo të jashtëm, plotësohen më një aspekt mjaft të rëndësishëm sic është dhe adresimi i gjetjeve apo rekomandimeve të lëna në raportet përkatëse në strukturat apo organet përkatëse, sipas impaktit që kanë këto gjetje. Pas çdo procesi vlerësimi që shoqërohet me gjetje dhe detyra për njësitë /strukturat përkatëse, hartohet plani i masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna. Referuar vendimit të fundit të akreditimit institucional rezulton që të jenë lëna rekomandime për përmirësim. Sigurimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm dhe dinamik i cili kërkon përveç mekanizmave të konsoliduar edhe ndërgjegjësim të personelit akademik, administrativ dhe të studentëve. Proceset e vlerësimit në kuadër të akreditimit që janë zhvilluar në AU, kanë patur impakt në ndërgjegjësimin e të gjithë strukturave, personelit akademik dhe tek studentet, për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Për të rritur këtë impakt dhe kulturën e vetë ndërgjegjësimi, NJSBC vazhdimisht organizon takime me strukturat e rektoratit dhe fakulteteve për të rritur efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijimësi të saj. Takime periodike kryhen edhe me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale të institucionit me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.				
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.				
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	<b>X</b>
--	-----------------------	----------------------	-----------------------	----------





**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Administrim Biznesi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Albanian University”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Fakulteti dhe Departamenti ka fituar eksperiencë, çka e lehtëson procesin e realizimit të programit të studimit në kërkesat e standardeve. U bënë disa vite që Departamenti punon me këtë program studimi dhe është fituar edhe përvoja e duhur për kalimin nga Master me 90 kredite në Master me 60 kredite.
2. Fakti që gati gjysma e studentëve të regjistruar në këtë program studimi janë të punësuar në bizneset e tyre familjare apo në biznese të tjera apo në zyra të ushtrimit të profesionit të kontabilistit apo të konsulentit financiar është një avantazh edhe për kuptimin më të mirë të koncepteve dhe për të përvetësuar më mirë dhe më shpejt programin e studimit dhe integrimin në përmbajtjen e tyre.
3. Angazhimi në procesin e mësimdhënies të një numri relativisht të konsiderueshëm të pedagogëve që janë njëherësh edhe titullarë të lëndëve, si edhe të profesionistëve të jashtëm, me tituj dhe grada shkencore, është një avantazh që ndihmon në lidhjet e studentëve dhe të mësimdhënies me praktikën. Në program janë angazhuar pedagogë që vijnë nga Bankat e nivelit të dytë, nga kabinete të shërbimeve të kontabilitetit dhe të konsulencave fiskale si dhe nga kompani të shërbimeve të auditimit dhe të tregut financiar.
4. Lidhjet e programit me bizneset si dhe numri relativisht i lartë i marrëveshjeve të bashkëpunimit me to është një shenjë e mirë e materializimit në teren të formimit teorik dhe konkretizimit të praktikave kontabël dhe financiare të lëndëve specifike.
5. Infrastrukturat në dispozicion të programit janë të mjaftueshme dhe brenda standarteve duke krijuar mundësi dhe lehtësi për procesin e mësimdhënies.
6. Ngarkesa e numrit të studentëve për një pedagog nuk është e lartë cka premtion për ndjekjen e tyre edhe në veprimtaritë jashtë fakultetit.
7. Ndjekja e studentëve mbas diplomimit dhe raportet e tyre deri pesë vite mbas punësimit është një praktikë e mirë.
8. Reflektimi në detyrat dhe rekomandimet e vëna nga Bordi i Akreditimit në procesin e realizuar para tre viteve ka qenë pozitiv dhe vihet re një lloj angazhimi për të reflektuar dhe përmirësuar punën.

**Pika të dobta**

1. Kriteret e pranimit nuk bëjnë filtrin e duhur të studentëve që në vitet e studimit në nivelin bachelor nuk kanë pasur formim me bazë ekonomie. Në këtë mënyrë, kriteret lejojnë hyrjen në program edhe të studentëve nga shkencat sociale të cilët e kanë të



vështirë apo të pamundur ndjekjen e programit pa marrë paraprakisht formim me baze ekonominë. (Standarti V.1, kriteri 3).

2. Vihet në pah rënia e numrit të studentëve të rregjistruar në këtë program studimi dhe në mënyrë të vecantë kjo rënie është akoma edhe më e theksuar kur bëhet fjalë për raportin numër të diplomuar cdo vit dhe të punësuar në profesion, edhe pse ky mund të jetë një fenomen pak më i gjerë se sa studentët e një programi studimi të parë vecmas (Standarti I.3, kriteri 8).
3. Raporti PAE/PAK për këtë program studimi nuk përmbush standartin 75%/25% për mbulimin e orëve mësimore. Numri i stafit akademik PAK ka ardhur në rritje ndër vite duke mbuluar në këtë mënyrë pjesën më të madhe të orëve mësimore (për vitin akademik 2021-2022, 64% të orëve mësimore në auditor për këtë program studimi, mbulohen nga PAK) (Standarti II.5, kriteri 2).
4. Puna e studentëve me diplomat dhe integrimi i tyre në këtë proces nuk ishte shumë i qartë dhe në kohën e duhur. Jo të gjithë studentët ishin të qartë dhe të mirë informuar për punimet e tyre të diplomave dhe drejtuesit e tyre (Standarti II.5, kriteri 4 dhe Standarti III.3, kriteri 10).
5. Frekuentimi i dobët i studenteve dhe akses i dobët për të përdorur infrastrukturën e shkollës (psh. Bibliotekën) dhe të Departamentit për shkak të mësimit 17.00-20.00 (Standarti III.3, kriteri 5 dhe Standarti IV.4, kriteri 6).
6. Mësimi zhvillohet cdo ditë 17.00-20.00 (çdo ditë 3 orë), por kaq orë mësimi nuk janë të mjaftueshme për orët në auditor sipas lëndëve me kreditet përkatëse të përcaktuara në planin mësimor (Standarti III.2, kriteri 1).

### Rekomandime

1. Për kategorinë e studentëve që nuk kanë njohuri në fushën ekonomike në ciklin e studimeve Bachelor, duhen parashikuar cikle leksionesh parapërgatitore dhe integruese në të paktën 3-4 lëndë para se të fillojë procesi i leksioneve dhe mësimit të rregullt.
2. Përmirësimi i raportit PAE/PAK duke rritur numrin e stafit akademik të punësuar me kohë të plotë.
3. Respektimi i rregullores dhe procedurave për punimin e diplomës duke respektuar afatet për përzgjedhjen e temës dhe statet e punimit për të synuar punime diplomash cilësore.
4. Ndërmarrja e masave nga Institucioni për patur akses studentët edhe në orët e mbasditës në ambientet e Institucionit (psh. Biblioteka) në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimnxënies.
5. Ndërmarrja e masave duke zgjatur numrin e orëve faktike të mësimit në auditor për të respektuar dhe zbatuar orët e deklaruara në planin mësimor.




## Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master Professional in "Business Administration" of the Institution of Higher Education "Albanian University"

### Strengths and affirmations


1. The Faculty and the Department has gained experience, which facilitates the process of implementing the study program in standards requirements. It has been several years since the department works with this study program and has also gained the right experience to move from a master's with 90 credits to 60 credits.
2. The fact that nearly half of the students enrolled in this study program are employed in their family businesses or other businesses or in the office of the accountant or financial consultant is an advantage of understanding better concepts, as well as to adapt better and faster with the study program and to integrate into its content.
3. Engaging in the teaching process of a relatively significant number of lecturers who are also titular of subject, as well as external professionals, with titles and degrees, is an advantage that helps student in connections of teaching with practice. The lecturers engaged in this program are coming from commercial banks, accounting and fiscal consulting services and financial market services.
4. Program links with businesses as well as the relatively high number of cooperation agreements with them is a good sign of materialization in the theoretical training and concretization of the accounting and financial practices of specific subjects.
5. The infrastructures available to the program are sufficient and within the standards creating opportunities and facilities for the teaching process.
6. The number of students for a lecturer is not high that promises to pursue them in activities inside as well as outside the faculty.
7. Following students after graduation and their reports up to five years after employment is a good practice.
8. Reflection on the tasks and recommendations set by the Accreditation Board in the process carried out three years ago has been positive and there is a kind of commitment to reflect and improve work.

### Weakness

1. The admission criteria do not make the right filter of students who, in the years of study at the Bachelor level, have not had economics -based training. In this way, the criteria allow the enrollment of students from the social sciences who find it difficult or impossible to follow the program without taking the economy based in advance. (*Standard V.1, criterion 3*).
2. The decline in the number of students enrolled in this study program is highlighted and in particular this decline is even more pronounced when it comes to the number of graduates each year and employed in the profession, although this may a slightly wider phenomenon than just students of a study program. (*Standard I.3, criterion 8*).



70





3. The report PAE/PAK, for this study program does not meet the standard of 75%/25% for lectures coverage from academic staff. The number of academic staff has been increasing over the years, thereby covering most of the lessons (for the academic year 2021-2022, 64% of the lectures for this study program, covered by PAK) (*Standard II .5, criterion 2*).
4. Students' work with diplomas and their integration into this process was not very clear and in a timely manner. Not all students were clear and well informed about their thesis work and their tutors (*Standard II.5, criterion 4 and Standard III.3, criterion10*).
5. Poor attendance and access of students to use university and department infrastructure (for example library) due to lesson at 17.00-20.00 (*Standard III.3, Criterion 5 and Standard IV.4, criterion 6*).
6. Lesson takes place every day 17.00-20.00 (daily 3 hours), but 3 hours of lesson are not sufficient for hours in the auditorium according to the relevant credits set out in the syllabus (*Standard III.2, criterion 1*).

### **Recommendation**

1. For the category of students who do not have knowledge in the economic field in their bachelor studies, preparatory and integrative lecture cycles in at least 3-4 subjects should be provided before the process of lectures and regular learning begins.
2. Improving the PAE/PAK report by increasing the number of full -time academic staff.
3. Respect for the regulations and procedures for the thesis by observing the deadlines for the selection of the topic and the stages of the work to aim for quality diplomas.
4. Taking actions from the institution to create access to students in the afternoon in the facilities of the institution (for example library) in the context of improving the quality of learning.
5. Taking actions by extending the number of factual hours lectures in the auditorium to respect and implement the hours stated in the syllabus.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

